

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5511  
E mërkurë, 27 qershor 2018  
çmimi 0.40 €

Negociatat me  
Shqipërinë shtyhen për  
në qershor të vitit 2019



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**VUÇIQI, REFERENDUM PËR  
DIÇKA QË NUK I TAKON;  
HASHIMI, I DORËZUAR PËR  
DIÇKA QË DUHET TA MBROJË!**

F. 12



Behxhet  
Sh. SHALA -  
BAJGORA

**MUAJ I  
GODITJEVE TË  
MËDHA, MUAJ  
TRISHTUES!** F. 12



Ylber ÇITAKU

## EKONOMI

**MPMS-JA U OFRON 500  
VETAVE TRAJNIME DHE  
KËSHILLIME NË BIZNES** F. 9

## KULTURË

**MINISTRI GASHI: OBJEKTI I  
AGJENCISË SË ARKIVAVE DO  
TË RINOVHET TËRËSISHT** F. 10

## SPORT

**DRITA DEBUTON ME FITORE  
NË LIGËN E KAMPIONËVE** F. 14

**SOT VENDOSËT FATI I  
ZVICRËS, BRAZILIT DHE  
GJERMANISË** F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", ABELARD TAHIRI | FAQE 4-5

## Nuk frikësohemi nga mocionet e votëbesimit

Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka bërë me dije se Qeveria është duke funksionuar pa ndonjë problem dhe se nuk ka arsye të mendohet se nuk do të mund ta çojë mandatin deri në fund. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kabineti qeveritar po funksionon si një trup i vetëm, me qasje më serioze në shëndetësi, mirëqenie sociale, sundim të rendit dhe ligjit, në integritet euroatlantik, si dhe në zhvillim ekonomik. Sipas Tahirit, në aspektin e qeverisjes nuk parashihet të ketë ndonjë deficit që do ta cenonte jetëgjatësinë e Qeverisë Haradinaj. Ai ka thënë se koalicioni qeverisës nuk ka arsye të frikësohet nga mocionet e votëbesimit dhe as nga iniciativat e tjera opozitare. Tahiri ka theksuar se një opozitë produktive është në të mirë të Qeverisë

"EPOKA E RE" SJELL PËRMBAJTJEN E  
PROJEKTLIGJIT PËR PAGAT I CILI  
ËSHTË NË DËGJIM PUBLIK

**Presidenti,  
kryeparlamentari  
dhe kryeministri  
do të jenë zyrtarët  
më të paguar  
shtetërorë**



Presidenti i Republikës së Kosovës do të jetë zyrtari më i paguar në vend sipas Projektligjit për pagat të cilin e ka siguruar gazeta "Epoka e re". Presidenti do të marrë pagë mujore 2 868 euro. Pas shefit të shtetit, zyrtarët më të paguar shtetërorë do të jenë kryeministri, kryetari i Kuvendit dhe ai i Gjykatës Kushtetuese, të cilët do të marrin pagë mujore 2 390 euro. Duke iu referuar këtij projektligji, paga e ministrave do të jetë 1 792 euro, po kaq edhe e deputetëve | FAQE 8-9



**Veseli: Të shtohet komunikimi  
me BE-në për heqjen e vizave** | FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Pritren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Ivanovi nuk e nënshkruan vendimin për ndryshimin e emrit të Maqedonisë

SHKUP, 26 QERSHOR - Presidenti maqedonas Gjorgje Ivanov ka bërë me dije se nuk e nënshkruan vendimin e Parlamentit për ratifikimin e marrëveshjes për ndryshimin e emrit të Maqedonisë. "Nuk kam mandat që ta nënshkruaj vendimin. Një nga shtyllat e politikës sime të programit parazgjedhor ka qenë se nuk pranoj ndryshimin e Kushtetutës me qëllim ndryshimin e emrit kushtetues", tha Ivanov në një komunikatë të lëshuar nga zyra e tij. Ai thekson se

nuk pranon ide as propozime të cilat "do ta rezikojnë identitetin kombëtar maqedonas, veçoritë e kombit maqedonas, gjuhën maqedonase dhe modelin maqedonas të bashkëjetesës". Ivanovi thotë se marrëveshja me Greqinë nuk ka bazë kushtetuese, se Ligji për ratifikimin e marrëveshjes nuk është në përputhje me nenet 51, 118 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Ai vlerëson se marrëveshja e vë Maqedoninë në një pozitë të nënrenditur dhe të varur ndaj një shteti

tjetër, përkatësisht ndaj Greqisë dhe kjo, sipas tij, "është e dënueshme me ligj prej më së paku pesë vjet burgim për personin që e bën këtë vepër". Parlamenti i Maqedonisë para një jave e miratoi me 69 vota marrëveshjen e nënshkruar në rajonin e Prespës greke më 17 qershor nga ministrat e jashtëm të Greqisë dhe Maqedonisë, Nikos Kotzias dhe Nikolla Dimitrov në praninë e kryeministrave të dy vendeve fqinje dhe të zyrtarëve të lartë të Bashkimit Evropian dhe të OKB-së.



## Negociatat me Shqipërinë shtyhen për në qershor të vitit 2019

Në takimin e së martës të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, që merret me përgatitjet e takimeve të Këshillit Evropian, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë përcaktuar udhërrëfyesin drejt hapjes së negociatave me Shqipërinë në qershor të vitit 2019, ku theksohet se nevojitet më shumë progres me reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

TIRANË, 26 QERSHOR - Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë përcaktuar tashmë udhërrëfyesin drejt hapjes së negociatave me Maqedoninë dhe Shqipërinë në qershor të vitit 2019, gjatë takimit të së martës të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, që merret me përgatitjet e takimeve të Këshillit Evropian.

Për Shqipërinë theksohet se nevojitet më shumë progres me reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërsa për Maqedoninë kërkohet progres në reformat kyçe, rezultate në luftën kundër korrupsionit, sikurse edhe ruajtja e thellimi i këtij momenti kyç të reformave aktuale.

Në një mesazh në "Twitter", Komisionari evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn shpreh kënaqësinë që Këshilli Evropian sheh më në fund dritë mbi konkluzionet e zgjerimit, veçanërisht mbi Shqipërinë dhe Maqedoninë e

Veriut, pas një debati të gjatë. "Rrugëtimi drejt hapjes së bisedimeve të anëtarësimit në qershor të vitit 2019 është i qartë. Një sinjal kyç ky për rajonin se progresi i bërë shpërblehet, sikurse edhe vendimtar për besueshmërinë e vetë BE-së", ka shkruar Hahn. Perspektiva e qartë drejt së ardhmes evropiane është dhe mbetet një prej prioritetëve të Presidencës bullgare të BE-së. Më herët gjatë ditës së martë, në përfundim të pjesës së parë të mbledhjes, ministri i Jashtëm grek Nikos Kotzias tha se ka dy grupime. "Njëri që përfaqëson shumicën, me 25 vende që mbështesin hapjen e bisedimeve deri në verën e 2019, dhe tre vende të tjera, Franca, Danimarka dhe Holanda që mendojnë se duhet të shtyjme të gjithë procesin. Por të shtysh këtë proces evropian do të thotë që të shtysh stabilitetin dhe sigurinë e të gjithë rajonit", u shpreh ai. Qëndrimi i Francës është ndikuar nga një sërë faktorësh. Nga një



anë janë ato që lidhen me situatën e brendshme, duke qenë se gati gjysma e forcave politike franceze dhe shumica dërrmuese e opinionit publik, janë kundër idesë së zgjerimit. Nga ana tjetër, ideja e presidentit Emmanuel Macron e shpallur si objektiv nga ana e tij, është ajo e reformimit të vetë BE-së, përpara zgjerimit të saj. Por ministri i Jashtëm grek u shpreh se unë e di që ka vende që i druhen populizmit, por nuk mundet ta luftosh dhe të fitosh ndaj populizmit, duke bërë hapa pas, tha ai duke shtuar se "mund të ecim paralelisht si me zgjerimin ashtu dhe me reformimin e BE-së".

Përpara nisjes së takimit ministri i Jashtëm holandez Stef Blok përsëriti qëndrimin hezitues të

vendit të tij. "Dy vendet kanë bërë progres por jo mjaftueshëm, duhen rezultate konkrete për korrupsionin. E rëndësishme është që të dy vendet kanë treguar këmbëngulje në luftën kundër korrupsionit por duhet të shohim më shumë. Ne mbështesim progresin që kanë bërë por nuk mund të injorojmë faktin që duhet të shohim rezultate konkrete", u shpreh ai.

Nga ana e saj Gjermania është në favor të hapjes së bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian me Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe i bën thirrje Francës dhe Holandës që të bashkohen me pjesën tjetër të vendeve anëtare që ndajnë të njëjtin qëndrim. "Demokracia dhe paqja e qëndrueshme në

Ballkanin Perëndimor luajnë një rol të rëndësishëm për të gjithë ne në BE, kjo është arsyeja që vlerësojmë shumë përpjekjet e të dy shteteve për të forcuar sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit", tha Roth. "Qeveria gjermane është gati të mbështesë Shqipërinë dhe Maqedoninë në rrugën drejt BE-së, jemi gati të japim dritën jeshile dhe dua të inkurajoj miqtë tanë holandezë dhe francezë të na bashkohen", tha ai.

Thirrje drejtuar vendeve anëtare në favor të hapjes së bisedimeve, drejtuan të martën dhe 11 eurodeputetë, relatorë dhe drejtues të delegacioneve të Parlamentit Evropian për marrëdhëniet me 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.

## Kathleen Kavalec, ambasadore e re ShBA-së në Tiranë

Tiranë, 26 qershor - Kathleen A. Kavalec do të jetë ambasadore e ShBA-së në Shqipëri, e cila do ta zëvendësojë ambasadorin Donald Lu.

Kavalec ka qenë zëvendësndihmësekretare për Zyrën e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike. Në gusht 2015

zëvendësndihmësekretare për Zyrën e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike në Departamentin e Shtetit. Në këtë cilësi ajo është përgjegjëse për Rusinë dhe për Zyrën e Çështjeve Rajonale. Më parë ajo ka shërbyer si drejtoreshë për Çështjet Ruse në të njëjtën

Zyrë.

Para kësaj ka qenë zëvendësdelegatë e përherëshme në Misionin e ShBA-së në UNESCO, në Paris (2010-2013). Në periudhën 2009-2010, Kavalec ishte zëvendëskoordinatorë për

Asistencën e ShBA-së për Evropën, Euroazinë dhe Azinë Qendrore. Ajo ka shërbyer më 2008-2009 edhe si drejtoreshë e Parandalimit të Konfliktëve në Zyrën e Koordinimit për Rindërtim e Stabilizim. Detyrat jashtë vendit kanë përfshirë edhe ture në Ukrainë, Rusi, Rumani e Brazil.





Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Haradinaj kërkon përfshirjen e Kuvendit në dialog me Serbinë



Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të martën se Kuvendi i Kosovës duhet të përfshihet në fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka vlerësuar se kjo fazë e procesit do të jetë e ndjeshme dhe institucionet e vendit duhet të kenë një komunikim të qëndrueshëm. Sipas kryeministrit, për këtë fazë të dialogut duhet të raportohet vazhdimisht në Kuvendin e Kosovës

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se në fazën finale të dialogut me Serbinë duhet të përfshihet edhe Kuvendi i Kosovës. Pas mbledhjes së Qeverisë, kreu i ekzekutivit ka thënë se presidenti i vendit vetëm një herë në vit i adresohet Kuvendit të Kosovës dhe Kushtetuta e vendit nuk e parasheh që ai t'i raportojë më shumë Kuvendit, përveç në raste të jashtëzakonshme. Mirëpo, sipas kryeministrit, duhet gjetur një formulë që komunikimi ndër-institucional për procesin e dialogut të ekzistojë vazhdimisht. "Ndoshta do të ishte mirë që t'i raportojë Kuvendit. Pra, sipas bindjes sime, e rëndësishme është përfshirja e Kuvendit në procesin e dialogut. Qeveria komunikon me Presidencën dhe me presidentin, por është shumë me rëndësi që partitë parlamentare, edhe ato të opozitës, edhe të komuniteteve, ta kenë një instru-

ment komunikimi. Pra, ta dinë të vërtetën për dialogun", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë për medie. Ai ka vlerësuar se është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës të jetë drejtpërdrejt i përfshirë në procesin e dialogut me Serbinë. Po ashtu, ai ka treguar se i është dërguar një raport i ekipit punues për draftimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Mirëpo, Haradinaj ka kërkuar që ai material të përkthehet edhe në gjuhën shqipe pasi ishte i shkruar në alfabetin cirilik.

## Zona e Veçantë Ekonomike Amerikane shkon në Gjakovë

Qeveria e Kosovës ka miratuar formimin e Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane, e cila është vendosur të jetë në Komunën e Gjakovës. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka treguar se ky vendim është marrë në bazë të propozimit të grupit punues, të

cilin e ka themeluar Qeveria e Kosovës në muajin maj të këtij viti. "Janë hapur të gjitha mundësitë që të përgatitet plani i fizibilitetit. Shpresojmë të bashkëpunojmë edhe me USAID-in amerikan dhe kësajsoj ta kemi një adresë për investitorët amerikanë, për kompanitë amerikane në Kosovë, ku do t'i gëzojnë të gjitha privilegjet për ta

bërë atraktive ekzistencën e kësaj zone për investime në Kosovë", ka thënë Haradinaj. Ai e ka quajtur këtë lajm të mirë ekonomik dhe që vjen në prag të 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kryeministri Haradinaj ka informuar kabinetin qeveritar edhe për punën intensive për finalizimin e Projektligjit për

pagat. Ai ka thënë se ky projektligj është në fazën finale të përpilimit dhe në javën e ardhshme do të silltet për diskutim në Qeveri. Po ashtu, Haradinaj ka theksuar se në projektligj do të ketë rritje të pagave për Policinë e Kosovës, punëtorët shëndetësorë dhe për kategoritë e tjera të rëndësishme. Në këtë mbledhje të Qeverisë janë miratuar edhe tri konceptdokumente: Konceptdokumenti për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor që adreson nevojën e rregullimit të kësaj fushe në sistemin shëndetësor të Kosovës, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit, përmirësimit e kualitetit të jetës; Konceptdokumenti për rregullimin e shpronësimit të pronës së paluajtshme i cili adreson sfidat në implementimin e dispozitave të tanishme ligjore të përcaktuara në Ligjin për shpronësimet e pronës së paluajtshme; dhe Konceptdokumenti për rregullimin e fushës së marrëdhënies së punës, i cili ka për synim avancimin e kushteve të punës për punëtorët, realizimin e të drejtës së lehonisë, luftimin e punësimit informal, garantimin e standardeve minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar nisimën për lidhjen e marrëveshjes bilaterale për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.

## Qeveria ndan sërish 30 mijë euro për trajtimin mjekësor të Bujar Bukoshit



Qeveria e Kosovës për herë të dytë ka ndarë mjete për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjekësor jashtë vendit për Bujar Bukoshin. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Bukoshi është i sëmurë nga një sëmundje e rëndë andaj Qeveria ka mbuluar një pjesë të shpenzimeve për shërbimet mjekësore për të. Me propozim të kryeministrit Qeveria ka ndarë 30 mijë euro për Bukoshin nga kategoria e shpenzimeve rezervë. Qeveria edhe më herët kishte ndarë mjete për trajtimin mjekësor të Bujar Bukoshit.

## Thaçi, sekretarit të NATO-s: Transformimi i FSK-së në ushtri, i domosdoshëm

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se ka zhvilluar një bisedë telefonike me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg. Thaçi ka treguar se me Stoltenbergun ka folur për domosdosh-

mërinë e lëvizjes përpara në finalizimin e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë të armatosur. "Sot zhvillova një bisedë telefonike me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg. Biseduam për domosdoshmërinë e lëviz-

jes përpara në finalizimin e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë të armatosur shumetnike dhe profesionale. Ushtrinë e Kosovës do ta bëjmë duke u koordinuar gjithmonë me aleatët tanë", ka thënë presidenti Thaçi.





Flet për "Epokën e re", Abelard Tahiri

# Nuk frikësohemi nga m



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka bërë me dije se Qeveria është duke funksionuar pa ndonjë problem dhe se nuk ka arsye të mendohet se nuk do të mund ta çojë mandatin deri në fund. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kabineti qeveritar po funksionon si një trup i vetëm, me qasje më serioze në shëndetësi, mirëqenie sociale, sundim të rendit dhe ligjit, në integritet euroatlantik, si dhe në zhvillim ekonomik. Sipas Tahirit, në aspektin e qeverisjes nuk parashihet të ketë ndonjë deficit që do ta cenonte jetëgjatësinë e Qeverisë Haradinaj. Ai ka thënë se koalicioni qeverisës nuk ka arsye të frikësohet nga mocionet e votëbesimit dhe as nga iniciativat e tjera opozitare. Tahiri ka theksuar se një opozitë produktive është në të mirë të Qeverisë

timeve dhe parimeve personale që mund t'i kemi në përditshmërinë tonë, mendoj se ne jemi të thirrur për t'i zbatuar vendimet e nxjerra nga Qeveria.

**"Epoka e re":** Mund ta çojë mandatin deri në fund kjo Qeveri, sepse disa herë opozita ka përmendur mocion mosbesimi?

**Tahiri:** Qeveria është instrument konkret i përbërë nga një formulë e caktuar e partive politike që fitojnë zgjedhjet dhe në të cilën ndahet me pajtim fuqia politike e gjithsecilit partner qeverisës. Në këtë drejtim, Qeveria është duke funksionuar pa ndonjë problem dhe se për nga aspekti strukturor, nuk ka pse të mendohet se Qeveria Haradinaj nuk do të mund ta çojë mandatin deri në fund. Ndërsa përveç anës strukturore, pra Qeverisë, ende më e rëndësishme është qeverisja dhe fryma që e karakterizon atë. Në këtë drejtim Qeveria funksionon si një trup i vetëm, mbi parimet dhe objektivat që i ka

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 QERSHOR -

**"Epoka e re":** Z. Tahiri, nga jashtë po duket i zbehtë roli i PDK-së në këtë qeverisje. Sa jeni të kënaqur me funksionimin e koalicionit qeverisës PDK-AAK-Nisma dhe të tjerët?

**Tahiri:** Në radhë të parë konsideroj se Partia Demokratike e Kosovës në këtë koalicion, si partia më e madhe, është e përkushtuar për ta siguruar qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e

qeverisjes dhe këtë është duke arritur ta bëjë me vendosmëri. Prandaj jo vetëm se nuk është zbehur roli i PDK-së në këtë mandat qeverisës si partner koalicioni por, përkundrazi, është pikërisht PDK-ja ajo e cila është duke gjeneruar garancitë politike që koalicioni të rrugëtojë tutje për përmbushje të mandatit qeverisës dhe për përmbushje të objektivave politike në funksion të zhvillimit ekonomik, social e politik në Republikën e Kosovës. Natyrisht si koalicion i disa forcave politike ne jemi pjesë e

një qeverie unike e cila funksionon në unitet të plotë dhe në këtë drejtim, suksesi dhe performanca është e përbashkët, prandaj nuk ka asnjë lloj drejtimi të gjërave në performanca të caktuara që flasin se roli i kujt është dominant. Për ne është më rëndësi që si partnerë qeverisës t'i përmbushim obligimet tona ndaj qytetarëve dhe të njëjtën gjë e presim edhe nga partnerët e tjerë të koalicionit.

**"Epoka e re":** Si partnerë qeverisës, a jeni pro vendimit të

kryeministrit për rritjen e pagave, sepse ministri Hamza ka kundërshtuar këtë vendim?

**Tahiri:** Çështja e pagave është bërë temë diskutimi që ka tërhequr vëmendjen për një kohë të gjatë tashmë. Unë respektoj plotësisht edhe diversitetin e qëndrimeve në raport me vendimin e Qeverisë për pagat, dhe mendoj se një debat i tillë i zhvilluar tashmë që një kohë të gjatë ka kontribuar në përshpejtimin e rregullimit të kësaj çështje me ligj. Natyrisht, si ministër i Qeverisë, pavarësisht prej konsta-



# ocionet e votëbesimit



asnjë moment, por e veçanta e kësaj mënyre të qeverisjes, pjesë e së cilës jemi, është orientimi drejt zgjidhjes së këtyre problemeve e jo thjesht identifikimi i tyre. Në rrethana të zakonshme, edhe në aspektin e qeverisjes, nuk parashihet të ketë ndonjë deficit që do ta cenonte jetëgjatësinë e Qeverisë Haradinaj. Opozita në anë tjetër duhet të ketë një rol aktiv dhe të orientuar në debatet që lidhen me cilësinë e qeverisjes e jo vetëm të orientuara në debatet politike se kush është duke qeverisur dhe me kë. Prandaj, ne nuk kemi pse të frikësohemi nga mocionet e votëbesimit dhe as nga iniciativat e tjera opozitare sepse në esencë një opozitë produktive është në të mirë edhe të Qeverisë. Kjo, megjithatë, nuk e amnistion opozitën që të kërkojë zgjedhje të reja pa arsye, vetëm për faktin se është opozitë.

**"Epoka e re":** Këto ditë është përfolur shumë çështja e zgjedhjeve të parakohshme. Sa është e përgatitur PDK-ja për to?

**Tahiri:** Diskursi politik që zhvillohet në Kosovë është mjaft i pasur dhe për përmbajtjen e tij një rol të madh kanë edhe intelektualët, shoqëria civile, mediet, partitë politike që marrin pjesë në jetën parlamentare dhe jashtë saj. Diskutimet e tilla janë të zakonshme, por në rastin konkret dhe në kohën dhe hapësirën kur po flasim, zgjedhjet nuk janë duke u shtruar si alternativë brenda PDK-së. Për ne, primar është fokusi në politika publike cilësore që ndikojnë për të mirë në jetën e qytetarëve tanë dhe këtë fokus do ta mbajmë vazhdimisht si partner qeverisës. Përderisa fokusi ynë është diku tjetër, është e paqëndrueshme të flasim se a jemi të përgatitur për zgjedhje apo jo. Megjithatë, Partia Demokratike e Kosovës është gjithmonë e gatshme për t'u testuar përmes zgjedhjeve sepse

forca e saj nuk qëndron në përgatitjet e zgjedhjeve, por në idetë dhe parimet mbi të cilat është e ngritur dhe ka rrugëtuar përgjatë këtyre viteve.

**"Epoka e re":** Keni kërkuar përfundimin e reformës zgjedhore. Çfarë do të bëjë PDK-ja në këtë drejtim?

**Tahiri:** PDK-ja e udhëhequr nga z. Veseli, krahas përmbushjes së misionit politik e institucional, është duke u kushtuar rëndësi temave që janë pjesë e identitetit tonë si shoqëri demokratike, në mesin e të cilave edhe reforma zgjedhore. Ne mendojmë se është momenti që të hedhim në diskutim idetë tona mbi atë se çfarë reforme na duhet dhe në çfarë drejtimesh mund të formulojmë një sistem të përshtatshëm elektoral që garanton sigurinë, barazinë, si dhe përkthimin e saktë të besimit të qytetarëve të dhënë përmes votave në përgjegjësi politike. Në këtë drejtim, ne kemi kërkuar nga të gjitha partitë e tjera që të shtrojmë bashkërisht një diskurs të gjerë ku mund t'i ballafaqojmë pikëpamjet tona në lidhje me të ardhmen e sistemit zgjedhor në Republikën e Kosovës. Ekspertët tanë veçse janë duke punuar për formulimin e pikëpamjeve tona politike mbi këtë çështje dhe jemi shumë të hapur dhe insistues që gradualisht ta përmbylim këtë reformë të folur për vite të tëra.

**"Epoka e re":** Z. Tahiri, si është duke u zhvilluar procesi i brendshëm zgjedhor në PDK? Është caktuar mbajtja e konventës zgjedhore dhe a do ta kemi një PDK më të konsoliduar pas këtyre zgjedhjeve?

**Tahiri:** Procesi zgjedhor ka rrjedhur në përgjithësi jashtëzakonisht mirë dhe tashmë pothuajse janë përmbyllur mbledhjet konstitutive të strukturave të reja të rinisë së Partisë Demokratike të Kosovës

në të gjitha qytetet e Kosovës. Kjo fazë e zgjedhjeve në rininë e PDK-së që do të përfundojë në javën e parë të korrikut, siç dhe ishte planifikuar, është karakterizuar me potencialet e reja që i janë bashkangjitur vizionit të PDK-së dhe z. Veseli dhe jemi të bindur se trendi i tillë i rritjes së PDK-së do të reflektohet edhe në kuadër të konventës zgjedhore ku do të ketë hapësirë për intelektualë të rinj që t'i marrin përsipër përgjegjësitë politike. Pas përmbylljes së zgjedhjeve në strukturat rinore do të vazhdojmë sipas planit edhe me organizimin e Konventës Zgjedhore, së cilës jemi duke i kushtuar vëmendje të plotë që të karakterizohet nga mendësia e temave për të cilat do të qëndrojë PDK-ja në Dekadën e Re. Në aspektin tjetër, PDK-ja ka qenë dhe është parti shumë mirë e konsoliduar, megjithatë zgjedhjet e brendshme si dhe vizioni i z. Veseli si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës për dekadën në të cilën kemi hyrë, do të shënojnë një diferencë të madhe dhe, mbase, të pakrahueshme me formatin e funksionimit të deritanishëm të ndonjë partie politike në Republikën e Kosovës. Z. Veseli është jashtëzakonisht i përkushtuar që PDK-ja e Dekadës së Re të jetë PDK-ja që do ta ofrojë alternativën më të mirë jo vetëm të integritetit, gjithëpërfshirjes dhe politikave publike të mirëfillta, por edhe në përqendrimin ideor që lidhet me identitetin tonë si shoqëri progresive dhe e gatshme për t'u zhvilluar krahas trendeve demokratikë, ekonomikë, politikë e socialë, duke zbritur referencat e politikës nga çështjet e përgjithshme në nivelin e individit dhe komunitetit, dhe duke i njohur e fuqizuar pjesëtarët e shoqërisë sonë pa dallim, para çdo gjëje tjetër, statusin e qytetarit që i garanton atij lirinë, zhvillimin dhe mirëqenien.

përcaktuar. Kur jemi te qeverisja, mendoj se tashmë është duke ndodhur një ndryshim i theksuar në disa drejtime të rëndësishme siç është një qasje më serioze në sektorin e shëndetësisë, mirëqenies sociale, sundimit të rendit dhe ligjit, dhe se është ndërtuar një klimë më e përshtatshme për

integrimin euroatlantik, zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe pozicionimin e Kosovës si një shtet me perspektivë të garantuar evropiane. Unë mendoj se ne si Qeveri, fokusin kryesor jemi duke e orientuar në këto tema. Natyrisht ka edhe plot sfida nga të cilat nuk kemi qenë imunë për

## Veseli: Të shtohet komunikimi me BE-në për heqjen e vizave

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka falënderuar institucionet e Bashkimit Evropian, eurodeputetët, për përkrahjen e madhe që i kanë dhënë procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka bërë me

dije se institucionet e Kosovës nuk duhet ta ndalin punën deri në përmbushjen e së drejtës themelore dhe meritore për të lëvizur lirshëm në Evropë. "Kemi filluar një iniciativë që ka gjetur mbështetje nga institucionet e vendit dhe nga shtetet anëtare të BE-së. Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për liber-

alizim të vizave, por këtu nuk përfundon i gjithë obligimi ynë. Në këta muaj vendimtarë ne duhet ta vazhdojmë përmbushjen e agjendës sonë evropiane, ndërsa komunikimi me të gjitha institucionet e BE-së dhe çdo mekanizëm tjetër ndikues në këtë proces duhet të shtohet", ka thënë Veseli.





## Latifi viziton punimet në Palestrën Sportive në qytetin e Rahovecit

RAHOVEC, 26 QERSHOR (ER) - Pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik për fillimin e punimeve në Palestrën Sportive në Rahovec, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar edhe nga Ervin Hoxha, drejtor i DKRS-së dhe Berat Duraku, drejtor i DPBZhR-së, kanë parë nga afër punimet të cilët janë duke u bërë nga kompania kontrak-

tuese nga ana e komunës. Përgjegjësit e firmës kontraktuese e kanë informuar kryetarin Latifi se fillimisht është bërë pastrimi i objektit brenda dhe në disa pjesë jashtë objektit të palestrës. Gjithashtu, ata kanë bërë me dije se punët janë duke shkuar sipas planit dhe deri më tani nuk është paraqitur ndonjë problem për uljen e ritmit të punëve.



## Mbështetet projekti për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan

GJILAN, 26 QERSHOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, së bashku me drejtorët komunalë dhe drejtorin e kompanisë "Hidromorava", Muhamet Suliqi, kanë pritur të martën në takim pune përfaqësues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

(BERZh) dhe Bankës Investive Evropiane (BEI) në Kosovë, me të cilët kanë diskutuar për projektet e mëdha të infrastrukturës nëntokësore. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e BERZh-it dhe BIE-së kanë bërë me dije se janë të gatshëm për ta mbështetur projektin e ndërtimit të impiantit për traj-

timin e ujërave të zeza dhe kolektorëve të ujërave të zeza. Ndërsa nënkryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli, ka falënderuar përfaqësuesit e BERZh-it dhe BIE-së në Kosovë për interesimin e tyre për t'i financuar këto projekte kapitale dhe tejet të rëndësishme për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Gjilanit.



## Nënshkruhet memorandumi për harta dhe adresa të rrugëve në Klinë

KLINË, 26 QERSHOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Klinës, Besim Hoti, së bashku me drejtoreshën për Gjeodezi dhe Kadastër, Njomëza Grabanica, drejtorin e Urbanizmit, Lorenc Marleku dhe zyrtarin për sistemin e adresave në Komunën e Klinës, Bajrush Shala, kanë pritur të martën në takim përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e dy institucioneve kanë nën-

shkuar një memorandum, ku pjesë e tij është edhe autoriteti norvegjez i hartave. Nëpërmjet këtij memorandumi autoriteti norvegjez i hartave do ta financojë shtypjen e hartave të shenjave të adresave, punimin dhe vendosjen e shenjave të rrugëve bazuar në specifikimet dhe për sasinë për të cilën u pajtuan palët. Gjithashtu, ky autoritet do të jetë përgjegjës për procedurat tenderuese dhe kontraktuese gjatë prokurimit.

## Haskuka: Komuna e Prizrenit do të jetë e hapur për qytetarë

PRIZREN, 26 QERSHOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka organizuar debat publik para qytetarëve dhe shoqërisë civile rreth punës së gjashtëmujorit të parë të vitit. Prezantimi i punës së gjashtëmujorit është bërë nga kryetari i kësaj komune, Mytsher Haskuka, i cili ka folur

rreth projekteve që janë zhvilluar gjatë kësaj kohe, si dhe atyre që do të zhvillohen në vijim. "Organizimi i debateve publike rrit transparencën komunale dhe krijon mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Komuna e Prizrenit do të jetë e hapur për

qytetarët çdo ditë e më shumë!", ka thënë Haskuka. Në këtë debat interesimi i qytetarëve ka qenë i madh, ndërsa pas përfundimit të prezantimit nga kryetari Haskuka, ata kanë pasur rastin ta marrin fjalën për të diskutuar rreth temave të ndryshme.





# Kosova përfiton 187 milionë euro nga nënshkrimi i marrëveshjes 'Evropa për qytetarët'

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

**BRUKSEL, 26 QERSHOR** - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka nënshkruar në Bruksel marrëveshjen për programin "Evropa për qytetarët" me drejtoreshën e përgjithshme për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi e Komisionit Evropian, Paraskevi Michou. Vlera e programit e kësaj marrëveshje është 187 milionë euro.

Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se programi do të jetë shumë i mirëseardhur për të rinjtë, pasi rrit ndërgjegjësimin për historinë dhe vlerat e përbashkëta evropiane. "Ky program inkurajon edhe

pjesëmarrjen demokratike të qytetarëve në nivelin e BE-së, duke zhvilluar kuptimin e qytetarëve për procesin e bërjes së politikave të BE-së dhe duke promovuar mundësitë për angazhim shoqëror dhe ndërkulturor dhe vullnetarizëm në nivel të BE-së", ka thënë Hoxha. Ajo ka theksuar se prioritetet specifike janë angazhimi demokratik dhe pjesëmarrja qytetare, si fushë që përfshin debatin e së ardhmes së Evropës dhe sfidimin e euroskepticizmit, promovimi i solidaritetit në kohë krizash, nxitja e dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimi i ndërsjellë, luftimi i stigmatizimit të emigrantëve dhe grupeve minoritare, si dhe Viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore 2018.



# Kodi i ri Civil do ta bëjë Kosovën të barabartë për të gjithë qytetarët

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**MITROVICË, 26 QERSHOR** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, së bashku me shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, kanë marrë pjesë të martën në tryezën e fushatës informuese "Kodi Civil modern qëndron për diversitet dhe mundësi".

Ministri Tahiri me këtë rast ka shprehur edhe një herë përkushtimin e tij që përmes ndryshimeve legislative, Kosova të bëhet e qasshme, e besueshme dhe e barabartë për të gjithë qytetarët. "Si ministër i Drejtësisë çdo ditë po përpiqemi që shtetin ligjor ta bëjmë më të qasshëm, të besueshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Drejtësia ka disa kup-



time. Por, përditshmëria e një shoqërie të lirë, të drejtë dhe në të cilën funksionin rendi dhe ligji, më së miri kuptohet përmes

drejtësisë që rregullon fushën civile të marrëdhënieve në mes njerëzve", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se Kodi i ri Civil do

ta avancojë edhe më tej sigurinë juridike në krijimin e marrëdhënieve civile. "Kodi Civil i Republikës së Kosovës do ta

garantojë zbatimin unik të parimeve të drejtësisë civile duke krijuar sigurinë juridike të nevojshme për krijimin, avancimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve civile, qoftë të natyrës familjare, pronësore apo të atyre të biznesit", ka thënë ministri Tahiri.

Ndërkaq shëfja e zyrës së BE-së, Nataliya Apostolova, ka vlerësuar rëndësinë e konsultimeve të tilla publike ku qytetarët mund të marrin pjesë në draftimin e legjislacionit kyç, sikurse që është kodi civil. Ajo ka thënë se kodi i ri do të ndihmojë në harmonizimin me MSA-në për rregullimin e çështjeve që ndërlidhen me pronën, familjen, trashëgiminë dhe obligimet në një mënyrë jodiskriminuese, duke përmirësuar të drejtat pronësore të femrës.

# Shqipëria konfirmon përkrahjen për bashkëpunimin policor me Kosovën

**TIRANË, 26 QERSHOR (ER)** - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, po qëndron në një vizë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ku është takuar me zëvendësministren e Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Rovena Voda. Në këtë takim është diskutuar për shtimin e bashkëpunimit në fushën e menaxhimit të migrimit.

Zëvendësministri Zeka ka shprehur mirënjohje për bashkëpunimin e deritashëm me Republikën e Shqipërisë dhe ka vënë në dukje se migrimi është një dukuri që nuk mund të menaxhohet vetëm nga një shtet, prandaj duhet të koordi-

nohen veprimet për të menaxhuar në mënyrë të përbashkët nga shtetet e Ballkanit perëndimor.

Në këtë takim u vlerësua se shkëmbimi i informatave, ndarja e përvojave, si dhe ndërveprimi i mekanizmave shtetërorë mes dy vendeve duhet të vazhdojë edhe më tej. Ndërsa zëvendësministria Voda ka theksuar se pala shqiptare do të vazhdojë të mbështesë Republikën e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare për bashkëpunimin policor, si dhe ka theksuar nevojën e avancimit të bashkëpunimit në fushën e hetimeve të përbashkëta për çështjen e migrimit ilegal.





"EPOKA E RE" SJELL PËRMBAJTJEN E PROJEKTLIGJIT PËR PAGAT I CILI ËSHTË NË DËGJIM PUBLIK

# Presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri do të jenë zyrtarët më të paguar shtetërorë



Presidenti i Republikës së Kosovës do të jetë zyrtari më i paguar në vend sipas Projektligjit për pagat të cilin e ka siguruar gazeta "Epoka e re". Presidenti do të marrë pagë mujore 2 868 euro. Pas shefit të shtetit, zyrtarët më të paguar shtetërorë do të jenë kryeministri, kryetari i Kuvendit dhe ai i Gjykatës Kushtetuese, të cilët do të marrin pagë mujore 2 390 euro. Duke iu referuar këtij projektligji, paga e ministrave do të jetë 1 792 euro, po kaq edhe e deputetëve

mujore prej 2 151 eurosh (koeficienti 9). Kurse Avokati i Popullit, nënkryetari i Kuvendit, kryeprokurori i

Prokurorisë Speciale, zëvendëskryeministri dhe zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese do të marrin pagë mujore 1 912 euro (koeficienti 8).

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Projektligji për pagat, i cili është në dëgjim publik së bashku edhe me dy projektligje që rregullojnë fushën e administratës shtetërore, shumë shpejt pritet të votohet në Qeverinë e Kosovës dhe të përcillet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Ky projektligj, një kopje të të cilit e ka siguruar gazeta "Epoka e re", parasheh nivelimin e pagave për të gjithë zyrtarët shtetërorë që marrin pagë nga buxheti i shtetit. Edhe pse në këtë projektligj nuk është përcaktuar se sa do të jetë një koeficient, "Epoka e re" nga burimet e veta ka mësuar se një koeficient nga dymbëdhjetë (12) sa janë gjithsejtë llogaritet të jetë 239 euro. Sipas këtij projektligji, presidenti i Kosovës do të jetë zyrtari më i paguar nga buxheti i shtetit. Ai do ta ketë pagën mujore 2 868 euro (koeficienti 12). Pas presidentit, në hierarkinë shtetërore, zyrtarët më të paguar do të jenë kryetari i Kuvendit të Kosovës, kryeministri dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Ata do ta kenë pagën 2 390 euro në muaj (koeficienti 10). Gjithnjë duke iu referuar këtij projektligji, kryetari i Gjykatës Supreme, kryeprokurori i Shtetit, kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kryetari i Këshillit Prokuroria do të marrin pagë

Grupi i Pozitave	Titulli i Pozitës	Nëngrupi i Pozitave	Koeficienti	Institucioni/Fusha e zbatimit
A	President i Kosovës	A1	12.00	
	Kryetar i Kuvendit të Kosovës	A2	10.00	
	Kryeministër i Kosovës			
	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	A3	9.00	
	Kryetar i Gjykatës Supreme			
	Kryeprokuror i Shtetit			
	Kryetar i Këshillit Gjyqësor			
	Kryetari i Këshillit Prokurorial			
	Avokat i Popullit			
	Nënkryetar i Kuvendit			
	Kryeprokuror i Prokurorisë Speciale			A4
	Zëvendëskryeministër			
	Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese			
	Auditori i Përgjithshëm i Kosovës			
	Deputet	A5	7.50	
	Drejtor i Agjencisë së Inteligjencës			
	Drejtori i Agjencisë për Kuriosion			
	Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese			
	Gjyqtar i Gjykatës Supreme			
	Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit			
	Kryetar i Dhomës së Posaçme			
	Kryetar i Gjykatës së Apelit			
	Ministër			
	Prokuror në Prokurorinë Speciale			
	Prokuror në Prokurorinë e Shtetit			
	Zëvendës Kryeprokuror Special			A6
	Komandat i FSK-së/Gjeneral Lejtnant			
	Kryetar i Kryeqytetit	A7	6.50	
Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit				
Gjeneral Major në FSK				
Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore				
Kryetar i Gjykatës Themelore				
Prokuror në Prokurorinë e Apelit	A8	6.00		
Gjyqtar i Gjykatës Themelore për Krime të Rënda				

## Ministrat do të paguhen 1 792 euro në muaj

Projektligji për pagat do t'i rregullojë edhe pagat e ministrave të Qeverisë së Kosovës. Ata pritet të marrin pagë mujore 1 792 euro (koeficienti 7.5). Kurse zëvendësministrat do ta kenë koeficientin gjashtë (6), që i bie se do të marrin pagë mujore 1 434 euro. Me koeficient 6 do të paguhen edhe kryetarët e komunave që kanë asamble komunale nga 41 deri në 31 asamblistë. Pas ministrave dhe zëvendësministrave, Auditori i Përgjithshëm, deputetët e Kuvendit të Kosovës, drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, ata të Gjykatës Supreme, kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, kryetari i Dhomës së Posaçme, ai i Gjykatës së Apelit, kryetari i Gjykatës së Apelit, prokurorët në Prokurorinë Speciale etj. do të marrin pagë mujore 1 792 euro (koeficienti 7.5). Me koeficient shtatë (7) do të paguhet komandat i FSK-së dhe kryetari i Prishtinës. Paga mujore e këtyre dy zyrtarëve shtetërorë do të jetë 1 673 euro. Ndërsa me koeficient 6.5 apo 1 553 euro në muaj do të paguhet: gjyqtarët e Gjykatës





së Apelit, gjeneralmajorët e FSK-së, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, kryetari i Gjykatës Themelore dhe prokurorët në Prokurorinë e Apelit.

### Këshilltarët politikë 1 do të paguhen 1 314 euro në muaj

Projektligji për pagat rregullon edhe pozitat e tjera shtetërore. Me koeficient gjashtë (6) apo me nga 1 434 euro në muaj do të paguhen: gjyqtarët e Gjykatës Themelore për Krime të Rënda, gjyqtarët mbikëqyrës në degët e gjykatave themelore, prokurorët në

Prokurorinë Themelore për Krime të Rënda etj.

Me koeficient 5.50 apo 1 314 euro do të paguhen shefi i kabinetit në Kuvendin e Kosovës, në Presidencë dhe në Zyrën e Kryeministrit. Me koeficient të njëjtë (5.50) do të paguhen edhe këshilltarët e lartë politikë 1 në Kuvend, Presidencë dhe Zyrën e Kryeministrit. Ndërsa me koeficient pesë (5) apo me pagë 1 195 euro në muaj do të paguhen anëtarët e organeve kolegjiale, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ambasadorët, këshilltarët juridikë në Gjykatën Kushtetuese etj.

### Pagat e profesorëve universitarë, mjekëve dhe stafit diplomatik

Për pozitat profesor i rregullt, profesor emeritus, këshilltar shkencor, si dhe për pozitën profesor i asocuar, koeficienti do të jetë pesë (5) apo 1 195 euro pagë në muaj. Ndërsa mjekët specialistë do ta kenë koeficientin katër (4) apo 956 euro pagë në muaj. Pagën mujore prej 788 eurosh apo koeficientin 3.30 do ta kenë pozitat: lektor në universitetet, asistent në universitetet, hulumtues i pavarur si dhe pozita mjek në specializim.

## MPMS-ja u ofron 500 vetave trajnime dhe këshillime në biznes

PRISHTINË 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, mori pjesë në konferencën për projektin "Stabiliteti socio-ekonomik i komuniteteve etnike pakicë dhe shumicë në Kosovë" që u mbajt në Prizren, mbështetur nga MPMS-ja dhe implementuar nga organizata gjermane "ASB" dhe Fondacioni PREDA Plus.

Reçica ka theksuar se objektivat e këtij projekti janë krijimi i vendeve të reja të punës dhe gjerimi i të hyrave për shumë familje. Ai ka shprehur zotimin e MPMS-së për t'u përkushtuar me të gjithë potencialin që këto objektiva të arrihen në përpikëri.

Reçica ka thënë se sot është një ditë e veçantë sepse projekti

për punësimin e një anëtar të familjeve që nuk kanë asnjë të punësuar i nisur në Prizren javë më parë, sot po sheh dritën e zbatimit. "E nisëm në Prizren. Takuam përfituesit e asistencës sociale për t'i dëgjuar hallet e tyre, ndërsa sot jemi kthyer prapë në Prizren me veprime konkrete, duke u ofruar 500 vetave trajnime, këshillime në biznes dhe nëngrante për fillimin e mikro-bizneseve dhe bizneseve të vogla, të cilat do të gjenerojnë të hyra të qëndrueshme për të gjithë përfituesit", është shprehur ministri Reçica. Ai ka theksuar se papunësia është preokupimi kryesor i tij dhe MPMS-së dhe për këtë janë duke punuar me përkushtim shumë të lartë për përmirësimin e situatës.



## Propozohet të hiqet nga ligji neni që kufizon importin e veturave më të vjetra se 10 vjet

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, i kryesuar nga kryetarja Sala Berisha-Shala, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, në të cilën ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete. Po ashtu, komisioni shqyrtoi edhe Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme", si dhe

raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017.

Deputeti Mërgim Lushtaku arsyetoi iniciativën e tij për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit për automjete, ndërsa pas diskutimeve, komisioni i dha mbështetje projektligjit. Mbledhja vazhdoi me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme".

I pranishëm ishte edhe zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Faton Thaçi. Ai



paraqiti para komisionit qëllimin dhe rëndësinë e kësaj marrëveshjeje. Thaçi tha se marrëveshja ka për qëllim të ofrojë qasje më të

madhe në krijimin dhe zgjerimin e biznesit. Pas pyetjeve në adresë të përfaqësuesit të ministrisë dhe sqarimeve nga ana e tij, komi-

sioni përkrahu Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Gjatë kësaj mbledhjeje u paraqit edhe Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017. Të pranishëm ishin anëtarë të Bordit, të cilët para komisionit shpalosën punën e AKP-së gjatë vitit 2017. Ata theksuan se viti 2017 ishte viti më i suksesshëm i kësaj agjencie që nga ekzistimi i saj.

Deputetët shtruan pyetje në adresë të përfaqësuesve të AKP-së dhe pas përgjigjeve të marra, në mungesë të kuorumit, ky raport u shty për mbledhjen e radhës të komisionit.



# VUÇIQI, REFERENDUM PËR DIÇKA QË NUK I TAKON; HASHIMI, I DORËZUAR PËR DIÇKA QË DUHET TA MBROJË!



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

**Kryenegociator me lejen e Bajram Begut:** Hashim Thaçi shkoi në Bruksel për të arritur një "marrëveshje historike" me Aleksandar Vuçiqin, despotin e Serbisë, i veshur me Prada. Për nga eleganca Hashimi nuk ia lëshon rrugën aspak duke iu falënderuar disenjatorëve që paguhen mirë që, së paku, pamjen e jashtme ta ketë evropiane e përmbajtjen... nuk po e komentoj se çfarë e ka. Vuçiqi po tregton me tokat e Kosovës, pavarësinë e Kosovës dhe sovranitetin e Kosovës, pas krimeve të pashembullta dhe të padënuara që i ka bërë idoli i tij shpirtëror, politik dhe serbo-madh, Slobodan Millosheviq dhe Vojislav Sheshel, sikur edhe vetë Aca.

I pari është diku në rrethin më të rëndë të kazanit të Ferrit të Dante Aligerit, kurse i dyti, i shndërruar në një palaço, dalë mode, me marrëzitë që do t'i riciklojë, po përpiqet të mbetet në qendër të vëmendjes, qoftë edhe si i marrë që është. Vuçiqi e ka shumë lehtë sepse me asgjë nuk po e rrezikon Serbinë, kurse skajshmërisht po e rrezikon Kosovën. Në këto "bisedime" nuk po bisedohet për Mollën e Kuqe dhe krimet e Serbisë ndaj shqiptarëve, që nga themelimi i shtetit serb të cilit, paraardhësit e Erdoganit ia njohën pavarësinë derisa shqiptarët i shtypnin dhe mbytnin me dhunë dhe mizori. Nuk po bisedohet për spastrimin etnik të Toplicës, rajoneve të banuara me shqiptarë në Serbinë, pas shpalljes së pavarësisë nga Perandoria

Otomane. Nuk po bisedohet për elaboratet e Garashaninit, Çubrilloviqit dhe Ivo Andriqit, për krimet ndaj shqiptarëve gjatë dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, për Masakrën e Tivarit, masakrën e Drenicës, shpërnguljen e dhunshme në Turqi, aksionin e mbledhjeve të armëve, konferencën e Prizrenit, burgosjen dhe vrasjen e dhjetëra-mijëra shqiptarëve, së paku 12 000 civilëve të vrarë në luftën e fundit, për varrezat masive në Batajnicë dhe Petrovo Sello ku janë ekzekutuar shqiptarë të zënë robër luftime apo është eksperimentuar mbi mbetjet mortore të shqiptarëve të ekzekutuar pa gjyq. Nuk po bisedohet për një numër të madh të femrave të dhunuara shqiptare, si krime luftime, për qindra-mijëra ushtarë shqiptarë të dënuar dhe vrarë në armatën e ish-Jugosllavisë, për zhdukjen e mijëra shqiptarëve dhe joserbëve, për spastrimin etnik të Kosovës nga janë përzënë afërsisht 1 000 000 shqiptarë, për 193 varreza masive, për 264 vrasje në masë, për shkatërrimin e mbi 120 000 banesave, shtëpive, ekonomive familjare, objekteve fetare, kulturore, sportive dhe për minimumin e një hapësirë të madhe të tokës së Kosovës. Nuk po bisedohet për vjedhjen e dokumenteve origjinale kadastrale dhe të arkivave të Kosovës, për grabitjen e kursimeve të qytetarëve të Kosovës si dhe fondit pensional. Nuk po bisedohet për helmimin e mijëra nxënësve shqiptarë dhe nuk po bisedohet për krime të luftës që i ka bërë Serbia në Kosovë, për dorëzimin e të dyshuarve për krime luftime që janë strehuar dhe janë nën përkuqdesje të shtetit serb. Nuk po bisedohet për zhduqimin e atyre që janë dëmtuar pavarësisht prej përkatësisë etnike, fetare, moshore, gjinore, statusit shoqëror etj. Nuk po flitet për krimet e Serbisë në Kosovë pas përfundimit të luftës dhe

ndërhyrjeve flagrante në punët e brendshme të Kosovës. Nuk po flitet për gjërat që i bisedojnë dy shtete, por vetëm për çështje që janë ekskluzivisht punë të brendshme të një shteti. Bashkësia ndërkombëtare e cila po shitet si lehtësues i këtyre bisedimeve në fakt po e dhunon, së bashku me Serbinë dhe këta leshkot tanë që, kinse, po e përfaqësojnë Kosovën, vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe përcaktimin përmes referendumit se si duan të jetojnë dhe me kë duan të jetojnë. Në shtetet nga kanë ardhur këta dhunues të të drejtave të njeriut dhe demokracisë, edhe për neutralizimin e qenve endacakë, organizohet referendumi, kurse te në ky përcaktim demokratik i vullnetit të qytetarit është eliminuar edhe si mundësi teorike kurse, një pakicë kombëtare, jobashkëpunuese, e manipuluar dhe kontrolluar nga Beogradi është veshur me fuqi bllokuese që, kur të dojë dhe si të dojë, mund ta bllokojë vendimmarrjen demokratike dhe të ligjshme të shumicës.

**Goglat prej makushi të Vuçiqit dhe goglat prej harabeli të Hashimit:** Makushi është koqemadh dhe makushja i bënë vetë e mëdha që paraqesin ngarkesë edhe për një që ka muskuj të fuqishëm. Harabeli i ka goglat aq të vogla sa që për t'i parë duhet ta përdorni teleskopin e koordinatorit për mjedis, Mendim Rugovës, kurse makushja i bënë vezët mikroskopike. Këtë hyrje e bëra për t'i krahasuar koqet e Vuçiqit me mbetjen e koqeve të Hashimit. Vuçiqi po i qet koqet në tavolinë për gjëra që, as nuk janë çështje e Serbisë e as e Vuçiqit, kurse Hashimi po i mbanë mbetjet koqore nën tavolinë për punë që janë çështje ekskluzive e Kosovës dhe rrjedhimisht e Hashimit sikur edhe e të gjithë neve. Vuçiqi në këtë takim ishte pajisur me dokumentacion dhe letra, kurse Hashimi, me duar

në xhepa, ishte i shoqëruar me llaskuçë si çifti i Bekimit, profiter si puna e Blerimit, tregtar si çështje e Gjetit dhe vetë Hashimi, si i dorëzuar i kokë e këmbë, si para Mogerinit ashtu edhe para Vuçiqit.

Hashimi pa mandatin e Kuvendit të Kosovës nuk mund të bisedojë për Kosovën dhe kufijtë e saj. Nëse e do aq shumë Vuçiqin, le t'ia falë Shtëpinë e Mallrave në Gostivar. Ky aset nuk është në Kosovë dhe as Kosova nuk humbet, madje as Hashimi. Eventualisht mund të humbë KEDS-i i Erdoganit. Nëse Kosova është Republikë parlamentare dhe, sipas Kushtetutës, e tillë është, deputetët e Kuvendit mund ta mandatojnë Hashimin si kryenegociator. Nëse Hashimi me hashimët e tjerë e ka privatizuar në atë masë Kosovën duke e shndërruar në Republikë Hashimiste (disi sikur në Jordani), deputetët e Kosovës duhet të shkojnë nëpër shtëpia dhe të mos e durojnë injorimin dhe turpërimin që u bëhet nga një ekip llaskuçësh dhe profiterësh që flasin në emër të tyre. Nëse janë deputetë që e ndiejnë veten si të zgjedhur të popullit, me mendje, përmbajtje dhe veprim, duhet ta tërheqin për veshi Hashimin në Kuvendin e Kosovës sikur kur gjykata urdhëron praninë me forcë të një të dyshuarit nëse ai refuzon ftesën e rregullt të Gjykatës. Nëse Hashim Thaçi e merr bekimin (një llaskuç me këtë emër e ka si patericë permanente) e deputetëve për të qenë kryenegociator atëherë nuk kanë kuptim fare lotët sikur të serialeve latino-amerikane të Dullë Hotit apo kërcënimet e Lenës dhe mobilierisë Bini. Në atë rast Hashimi duhet të përkrahet, të ndihmohet dhe të mbikëqyret. Nëse Hashim Thaçi nuk e përfaqëson Kosovën, por pesë (5) ambasadat më të fuqishme në Kosovë, lehtë do ta ketë me Vuçiqin, le

të flasë në emër të atyre pesë shteteve të cilat, duke mos reaguuar në pohimet e Hashimit, në heshtje po e pranojnë Hashimin si kryenegociator. Bekim Paterica po thotë se afati kohor për përmbyllje të këtyre bisedimeve dhe arritja e "marrëveshjes historike" është 6 - 8 muaj. Nëse këtë shtatzëni negociatoro-politike e krahasoni me një shtatzëni të vërtetë dhe bëni krahasime atëherë duhet ta keni të qartë se shtatzënia 6-8 muaj kryesisht dështon, mund të lindë foshnja me të meta dhe ekstremisht rrallë përfundon mbarë. Duket se kjo shtatzëni negociatore-politike e llogaritur të zgjasë 6-8 muaj, sipas "gjinekologut" Bekim Llaskuçi, është paracaktuar të jetë dështim për Kosovën. Pa asnjë dilemë. Madje, tash, pa fije turpi edhe ata që dikur u sakrifkuan për lirinë e Kosovës, sikur edhe këta hasanprishtinët modernë, që sakrifkuan çdo gjë për këtë Kosovë që s'e kemi, si puna e Begjës dhe vëllait të Boros, po deklarojnë se kemi bërë mjaft lëshime dhe se më nuk lëshojmë pe. Më së shumti që Serbisë mund t'i bëjmë lëshime është ta bëjmë Asociacionin si Republika Serpska (edhe ashtu ministri cub Jeftiq nuk po i pranon ligjet e Kosovës), t'i japin teritorë Serbisë kah Llapi, Istogu, Anamorava dhe t'ua njohim zonave të mbrojtura statusin eksterritorial siç e kanë ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike. Kur e kundërshtonim demarkacionin me Malin e Zi pata shkruar se kur Serbia të pranojë ta bëjë demarkacionin e kufirit me Kosovën, do ta puthim çdo pëllëmbë që e ka marrë Mali i Zi. Një ditë, gjatë bisedës me njëfarë pisi institucional, më tha se kufijtë e Kosovës duhet të drejtohen sepse estetkisht nuk janë në rregull. Ky farë hajduti po e luan rolin e disenjatorit Armani duke lëvizur kufijtë e Kosovës sikur të ishin të brendshme të një kurtizaneje poli-



tike. E pështyva në pafytyrën që e ka por, çuditërisht, nuk reagoi dhunshëm, por u largua me kërcënim: "Ta tregon ty Hashimi qejfin në kohën që ishte shndërruar në kondom të Hashimit ..."

Lexues të nderuar, po të m'i jepte dikush pesë milionë euro shpërblim, me kërkesën ta dizajnoj ekipin më katastrofal negociator dhe më të dëmshëm për Kosovën, do të mbesja me gishtërinj në gojë, asnjëherë nuk do të isha në gjendje ta komponoj një katërshë të tillë me Hashimin, Begjën, Blerimin dhe Bekimin. Banda e madhe e katërshës në Kinë, gjatë Revolucionit Kulturor Kinez, e dëmtoi kulturën kineze. Banda e katërshës në Kosovë ka gjasa reale ta shkatërrojë të ardhmen e Kosovës. Qofsha i gabuar në këtë parashikim!

**Aman, mos loboni, as për njo-hje të pavarësisë e as për liberalizim të vizave:** Hasan Prishtina i ditëve tona, që i mori të gjitha të mirat për vete, në emër të Kosovës nuk e ka lehtë t'i vesh pantallonat nga fluturimi i përditshëm. Ju kenë ënjtur të pasmet. Miku im i madh, Behgjet Pacolli, me të cilin e ndajmë një të kaluar të përbashkët patriotike dhe kombëtare, plot sfida dhe sakrificë, me role të ndara, ai në Lucifera e unë në Lepogllavë, nuk po lë vend pa shkuar dhe pa i lutur që ta njohin pavarësinë e Kosovës apo për ta penguar çnjohjen e kësaj pavarësie. Së fundi shkoi në Vjenë, Austri, ku lloboi që Austria ta njohë pavarësinë e Kosovës për të vazhduar në Afrikë, ku ka plot hamera, sidomos në Nigeri. Aman miku im i madh, Gjet Colli, ndërprite lobimin për njohje të pavarësisë se, jo që nuk po na njohin, por kanë filluar të na çnjohin edhe ata që na kanë njohur.

Gjeti është shumë i zoti. Me "artin e diplomacisë" që e zotëron, nuk kam asnjë mëdyshje se gjatë mandatit që e ka do t'i bindë Francën, Gjermaninë, Anglinë dhe Amerikën që ta njohin Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran e që deri më tani nuk e kanë bërë. Begjo, rri në Afrikë sa më gjatë, të premtoj se në momentin kur AKR-ja do t'i bëjë dy deputetë, do të thërras dhe do ta marr myzhdënë. Më beso se aq shumë na keni trullësuar me këtë lobim për njohje të pavarësisë sa kemi filluar të mos e njohim as njëri-tjetrin!

E kam një lutje edhe për Kadri Veselin, ta ndërpresë me urgjencë lobimin për liberalizim të vizave se, në të kundërtën, do të na fusin kufizim edhe për lëvizje brenda Kosovës. Merre vëllë këtë ekipin e shkëlqyer që e ke lobues, mos i dërgo në ndonjë muze apo teatër, se moti janë të gatshëm të dërgohen në muze,

ndërsa as aktorët më profesionistë të teatrit nuk do të dukeshin më qesharakë në përpjekjet lobuese që i bëjnë këta të ekipit tënd. Dërgoji në një qendër ku ka zbritje sezonale, nëse të duhet lista e qendrave të mëdha tregtare në Evropë ku pamëshirshëm mund të dhunohen kartelat bankare të institucioneve, pyetini Editën dhe Gjergjin, janë të paparë për këtë! Po çfarë lëvizje e lirë pashë Zotin, nuk po mund të lëvizim lirisht as nëpër rrugët e qytetit të propozura sikur në Kandahar dhe të vërsuara nga ujërat e zeza (m.ti) sikur edhe nga qentë e Shpend Ahmetit që e kanë fituar statusin sikur të ishin lopët e shenjta në Indi. Koincidenca e rastit apo... Nuk e di nëse ju ka rënë në sy lexues të nderuar një ngjarje, sigurisht e rastit, por që ka një ndërlidhje të çuditshme. Në ditën kur Hashimi u nis për Bruksel me Bekim Patericën, djalin e tij politik, në Kosovë hyri humanisti i madh amerikan me prejardhje shqiptare, Xhon Alite, me djalin biologjik.

**Vlora e pavarësisë, në mbrojtje të djalërisë:** Vlora e Shaipit dhe Salës është patriote, babin e ka artist, grafist, nënën sintaksiste. E konsideroj si ndoshta politikanen më të lexuar në Kosovë dhe që e njeh shumë mirë drejtshkrimin e gjuhës shqipe për dallim nga shumica e politikanëve që në jetën e tyre nuk e kanë lexuar as një roman të vetëm, madje as "Afërdita përsëri..." në katund apo "Lulja e kujtimit", literaturë kjo për nxënës të klasave të pesta të shkollës fillore. Vlora shkruan bukur, ka frymëzim artistik nga babai, kurse disiplinë gjuhësore nga nëna. E kam lexuar çdo shkrim të saj. Se është patriote nuk është aspak çudi, emri e detyron të jetë e tillë. Se është mbrojtëse e të gjithëve është fakt i njohur, edhe ndërkombëtarisht. E mbron Kosovën, kosovarët si pakicë kombëtare, pakicat kombëtare, komunitetin LGBT dhe është fanatike për të vërtetën. Pas fitores së Zvicrës ndaj Serbisë ku, shqiptarët dhe kosovarët e luajtën rolin kyç, Vlora reagoi si Tringë Smajli dhe Nora e Kelmendit, në mbrojtje të nderit kombëtar. Kur FIFA i dënoi me të holla fukarenjtë milionerë Xhaka, Shaqiri dhe Lihstajner, Vlora u hedh në aksion për t'ua kompensuar dëmin që për këta janë para të imta dhe që, pa asnjë problem, mund t'i shpenzojnë duke blerë Harribo. Kjo është ngutia e Vlorës dhe është shndërruar në standard të llamarinës, nxe-hemi shpejt, ftohemi edhe më shpejt. Më mirë do të ishte që këto para t'u dhuroheshin atyre që e shesin gjakun e trupit për t'i mbajtur familjet. Atyre që nuk e kanë të siguruar as edhe një bukë për një ditë. Atyre që vdesin në stolin e operacionit

për shkak se nuk kanë mundësi ta paguajnë anestezionin apo edhe penjtë për operim.

Fëmijëve që detyrohen të bëjnë punë të rënda edhe për burrat, për ta siguruar një kafshatë goje për familjen. Invalidëve të luftës që paratë ua kanë hëngër veteranët e Bllacës dhe Jazhinces. Ish-luftëtarëve të UÇK-së që komandantët e tyre, pa e shkrepur një plumb, janë bërë milionerë, ndërsa këta kanë mbetur raste sociale dhe shumë raste të tjera e që ka shumë në Kosovë. Ose, Vlorë, ato para që janë mbledhur, mos ia jepni Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit, por Hashimit, Bekimit dhe Blerimit sepse u duhen për Bruksel. Apo, jepjani Begjës dhe Ramizit sepse kur nuk u mjaftojnë paratë. Graniti dhe Xherdani janë patriotë të vërtetë dhe ata kurrë nuk do t'i marrin ato para, edhe në situatë kur nuk do të kishin para e lëre më kur kanë para të mjaftueshme, jo vetëm për veten e tyre, por edhe për t'i ndihmuar të tjerët. Ata që e duan kombin, identifikohen me të në çdo moment dhe i shërbejnë kombit, pa kërkuar asnjë shpëtim. Të tillë janë Xherdani dhe Graniti. Nëse ju koriteni, mos i futni në vallen tuaj.

E dashura Vlorë, në QKUK në Prishtinë po lufton për jetë, veprimtari i dëshmuar për çështje kombëtare, ish i dënuari shumëvjeçar për çështje politike, përkrahës aktiv i luftës Çlirimtare të Kosovës dhe UÇK-së, anëtar shumë kontribuues në kohët më të vështira dhe të rrezikshme të Zyrës së Përfaqësuesit Politik të UÇK-së në Prishtinë që udhëhiqej nga mendja, kuptimi, përmbajtja, sakrificimi dhe veprimi për liri të njerëzve të robëruar në përgjithësi dhe shqiptarëve në veçanti, i Pavdekshmi Bacë Adem Demaçi, Bajrush Behrami. Bajrush Behrami e ruajti nderin që e kishte, nuk e hëngri as të kaluarën e tij, të tashmen e as të ardhmen e tij, fëmijëve të tij dhe të gjithë neve, prandaj edhe mbeti pa përkujdesje institucionale, ndonëse kontributi i tij ishte i madh për këtë që e kemi. Ishte dhe mbeti opozitë e të gjitha dukurive të këqija me të cilat janë stolitur një numër jo i vogël atyre që, kinse, bëjnë politikë sot në Kosovë.

Vlorë, lutu për Bajrushin, se sakrificat e tij të ka bërë deputete, ministre dhe tash ambasadore. Mos të flasim për Përmendoren e Sakrificës Shqiptare, Bacën Adem Demaçi. Ata që u sakrificuan një shekull e më shumë janë rrënjët dhe trugu i lirisë, Graniti, Xherdani, Dua, Rita dhe të tjerët janë lulet e këtij trugu, lulet e popullit shqiptar. Mos më detyro të shkruaj edhe më shumë...



## KOMF-i: Më shumë mbrojtje për fëmijët viktimë të narkotikëve

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Abuzimit me Droga, Koalicioni i Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës për vëmendje dhe angazhim për mbrojtjen e fëmijëve të cilët janë viktimë të abuzimit me substanca narkotike. "Fëmijëve viktimë të abuzimit me narkotikë nuk u ofrohen shërbime të veçanta të rehabilitimit fizik dhe

psikologjik", është thënë në reagimin e KOMF-it. Gjithashtu, sipas kësaj organizate, nuk ekzistojnë as shërbime të veçanta dhe programe për parandalimin dhe riintegrimin e fëmijëve të cilët janë viktimë të abuzimit me narkotikë. KOMF-i ka thënë se Kosova duhet të krijojë mekanizma për grumbullimin e të dhënave dhe generimin e informatave më të qëndrueshme lidhur me nivelin e përhapjes së rasteve të abuzimit me narkotikë.



## Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2019 do të jetë mbi 15 milionë euro

**Drenas, 26 qershor (ER)** - Komuna e Drenasit ka organizuar debat publik me qytetarë për kornizën afatmesme buxhetore. Në këtë debat ku kanë marrë pjesë nënkryetari i Drenasit, Gani Sylaj, kryesuesi i Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarë të Komitetit për Politikë e Financa, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, qytetarë dhe përfaqësues të OSBE-së, është diskutuar për projektet prioritare për periudhën 2019-2021 në bazë të

qarkores buxhetore 2019/2021. Të pranishmit gjatë debatit kanë paraqitur kërkesat e tyre për investime kapitale në infrastrukturë, ku kryesisht kërkesat kanë qenë të fokusuar në projektet që kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës, asfaltimin e rrugicave në lagje, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe trotuareve. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Drenasit për vitin 2019 është i planifikuar të jetë mbi 15 milionë euro, ndërsa për investime kapitale janë planifikuar mbi 4.5 milionë euro.



# Muaj i goditjeve të mëdha, muaj trishtues!



Ylber ÇITAKU

Edhe pse muaji qershor deri në mbarim ka edhe një javë të plotë (javë kjo që mund të sjellë goditje të cilat nuk e befasojnë më qytetarin e këtij vendi), me të vërtetë ishte trishtues për secilin qytetar të Republikës së Kosovës. Ishte një periudhë e goditjeve të mëdha në Kosovë; goditjet filluan me miliona euro të kontrabanduara nga Ministria e Infrastrukturës për kompaninë "Bechtel Enka".

Javët e para të muajit qershor u përcollën edhe me goditje fatale të aksidenteve në komunikacion. Goditja e radhës gjatë këtij muaji ishte ndarja nga jeta e legjendës së futbollit, të madhit Fadil Vokrri, ku të gjithë u ndiem keq për humbjen e Vokrrit, e keqardhja shtojë edhe për faktin se ishte ende i ri, ishte njeri shumë pozitiv, ishte... në fund të fundit na la edhe keq, thjesht FFK-ja dhe sporti kosovar në përgjithësi ka pasur ende shumë nevojë për Vokrrin. Goditje tjetër ishte edhe varrosja e një vajze në të njëjtën ditë, në të njëjtat varreza, e cila nga

një vend perëndimor erdhi në Kosovë për t'i takuar familjarët (siç u bë e ditur familjarët nuk e pranuan) varrimi i të ndjerës u krye me ceremoni e rite fetare. Pjesëmarrës në varrimin e saj ishin vetëm dy hoxhallarë dhe avokatja, humanistja Miftari - Kloppner.

Ishin javë këto ku dheu mori miliona euro, legjendën e futbollit z. Vokrri, së paku gjashtë viktima të trafikut dhe një vajzë anonime. I lehtë u qoftë dheu i Kosovës që të gjithëve, madje edhe lekëve! Çdo fund e ka edhe një fillim, nëse këto ditë dhe javë ishin tragjike, së paku në vazhdim tragjikes iu shtua edhe komikja, u shënua 140-vjetori i Lidhjes së Prizrenit, lidhje kjo për të cilën sa herë që është folur e sa herë na është kujtuar, para syve tanë ka dalë shtëpia e vjetër e Lidhjes së Prizrenit si dhe personalitete e pjesëmarrës të kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme për kombin tonë, por tash e tutje sa herë të përmendet Lidhja e Prizrenit pashmangshëm besoj se në mendjen e secilit nga ne e para syve tanë do të na dalë mbesa e Mehmet Derallës dhe kryeministri i Kosovës duke e tërhequr dhunshëm për krahu zonjën në fjalë.

Talljet e kryeministrit të Kosovës me qytetarët dhe shtetin nuk kanë të ndalur. Miliona të kontrabanduara, gjoja penallti për "Bechtel Enka"-n, shpikja e pozitive "koordinatore" si dhe rritja e pagave për veten dhe njerëzit

rreth tij, janë qershia në tortën e Fitër Bajramit që sapo e festuam.

A ka birë nane, a ka birë k... siç thotë Edi Rama, që i del para këtij kryeministri të shturur?! Goditjet dhe tallja e kryeministrit me qytetarët, po edhe me partnerët e tanishëm, edhe me ish-partnerët nga opozita, nuk kanë të ndalur. Ja tri raste konkrete kur goditet partneri i madh i koalicionit, PDK-ja, ministri Hamza, prof. dr. Blerim Rexha, marrja e fjalës dhe piskatje (sikur kalit në pllug) ndaj ministrave dhe zëvendësministrave të PDK-së.

Një prej ministrave më popullor në Qeverinë Haradinaj është ministri Bedri Hamza por, siç shihet edhe me syrin e lirë, z. Hamza është halë në sy për kryeministrin, madje kryeministri lëshohet edhe në komentimin e qëndrimit individual të z. Hamza lidhur me pagat duke deklaruar se nuk është burrni që nuk e pranon pagën me rritje, pavarësisht kësaj qytetari i thjeshtë e vlerëson ministrin Hamza që respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por do ta vlerësonte edhe më shumë sikur të thoshte se Gjykata Kushtetuese ka të drejtë në vendimin e saj, por si ministër i Financave vendimin e zbatoi vetëm pas miratimit të Ligjit për pagat.

Sa i përket z. Rexha, ai me një status në "Facebook", në mënyrë krejt të thjeshtë, i tregoi kryeministrit se hajninë nuk e

ka sjellë nga Austria. Kjo u dëshmuua për të satën herë vetëm pak muaj më vonë me rastin e 53 milionëve të ministrit Lekaj, ministër që nuk është asgjë tjetër vetëm argat i kryeministrit.

Sa i përket talljes dhe arrogancës së kryeministrit me ministrat dhe zëvendësministrat e PDK-së kjo nuk do koment, që thotë fjala popullore "e ka gjetur shtegun e thyer". Disa prej anëtarëve të kabinetit qeveritar, të gjendur në këtë përbërje të kabinetit aksidentalisht, sigurisht se nuk e kanë as guximin e as kapacitetet t'u kundërvihen veprimeve e vendimeve të një kryeministri të shturur.

Kushdo që mendon se kryeministri Haradinaj është naiv, gabohet. Ai e ka kuptuar që edhe përkundër të gjitha këtyre shkeljeve, talljeve dhe përbuzjeve të Qeverisë në raport me qytetarët, partnerët dhe opozitën, konsekuenca nuk ka edhe për faktin se opozita është edhe më e shturur sesa vetë kryeministri dhe Qeveria, rrjedhimisht rreziku nuk ekziston.

Opozita si tërësi nuk arrin të artikulojë as edhe një qëndrim të vetëm, qoftë ai qëndrim lidhur me dialogun me Serbinë ose qëndrimin për shkeljet e një-pasnjëshme të Qeverisë apo qëndrimin lidhur me dyfytërsinë e z. Haradinaj në lidhje me demarkacionin.

Lideri opozitar z. Isa Mustafa me probleme shëndetësore, me një LDK në pritje të individëve

për ta marrë lidhshimin e partisë dhe duke harrur interesin për zhvillimet në vend.

Një LV ende e dërrmuar nga çarja e madhe dhe tendenca për tranzicion, çarje kjo që nuk mund të tejkalohet lehtë edhe për faktin se kjo ka ardhur edhe si rezultat i disa dukurive ende tabu për një pjesë të madhe të shoqërisë kosovare, si çështjet e tresheve, barit e vijat, kurse sa i përket tranzicionit me kollare e takime me ambasadorë e diplomatë perëndimorë, nevojitet kohë, periudhë kohore kjo e përafërt me një dekadë.

Sigurisht se PSD-ja si pjesë e opozitës nuk mund të nënvlerësohet së paku nëse merren parasysh numrat. PSD-ja me kryetar Shpend Ahmetin, i cili me një këmbë qëndron në pozitën e kryetarit të PSD-së e me tjetrën në pozitën e kryetarit të Prishtinës, nuk mund t'i ikë thënies popullore "as me shehër as me Barilevë", aq më tepër kur të dy këto këmbë duket se janë krejt të qelqta.

Mbështetur në fjalën popullore "Shpresa vdes e fundit", ne qytetarët e këtij vendi po shikojmë Kampionatin Botëror, me shpresë se fiton KY ose AI, por ne sigurisht që jo! Pas Kampionatit Botëror fillojnë edhe pushimet verore, të molisur nga vapa e të dremitur si në ëndërr, do ta kuptojmë goditjen e radhës që do të na vijë nga Qeveria - kryeministri. Në fund pyesim: A meritojmë më mirë!?

## Ministri Gashi: Objekti i Agjencisë së Arkivave do të rinovohet tërësisht

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të martën Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK). Gjatë kësaj vizite ministri zhvilloi takim me kryeshefin ekzekutiv të AShAK-së, Ramë Manaj, i cili ka njoftuar ministrin me gjendjen, kushtet dhe rrethanat e punës në këtë institucion. "Kjo vizitë bëhet në kuadër të vizitave që jam duke ua bërë edhe institucioneve vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por edhe komunave të Kosovës, për ta parë nga afër gjendjen në të cilën zhvillojnë aktivitetet këto institucione", ka thënë Gashi.

Ai ka premtuar mbështetje për Agjencinë e Arkivave të Kosovës për realizimin e një projekti i cili parasheh renovim në tërësi të objektit. "Ne kemi përfunduar një intervenim të vogël, kemi vendosur raftet e reja. Këtu zotohemi që Ministria e Kulturës dhe unë si

ministër do të jemi në mbështetje të drejtorit, menaxhmentit, stafit, por edhe për të filluar një investim të ri në këtë objekt, një investim të gjithanshëm, duke përfshirë depot, objektin, sistemin kundër zjarrit, pastaj aklimatizimin, aparatet për kontrollimin e lagështisë si dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për këtë institucion të rëndësishëm veçantë për vendin tonë. Është një projekt që e kemi tashmë të gatshëm", ka thënë ministri Gashi.

Duke folur për rëndësinë e madhe që kanë arkivat në Kosovë, ai ka theksuar se pasi që lënda arkivore ka rëndësi historike, kulturore, shkencore dhe ka cilësinë e monumentit të kulturës, ajo duhet të ruhet në mënyrë të përhershme. "Andaj në përputhje me rëndësinë e madhe që kanë lënda arkivore, ky investim në këtë objekt është një prej prioritetëve të Ministrisë andaj edhe procedurat për investim në këtë objekt do të hapen brenda



disa ditëve", ka thënë Gashi, duke shtuar se janë të interesuar ta shohin nga afër gjendjen e objekteve të arkivave ndërkombëtare në

gjashtë komunat e Kosovës, në mënyrë që edhe atje të intervenojmë në të ardhmen. Po ashtu, ministri i Kulturës, Rinisë

dhe Sportit, Kujtim Gashi, tha se bashkë me drejtorin janë pajtuar të iniciojnë ndryshim-plotësimin për Ligjin për Arkivat.



# Llausha në ditët e majit 1998

Kur gjelbërohen livadhet në Palluzhë, mugulli i bungave dhe i çarrave lëshon shtatin një pëllëmbë në Llaushë...



**Behram HOTI**  
(Mal Drenica)

(16 maj 1998, e shtunë,  
flakët e luftës së UÇK-së...)

Zbresim, krahu pranë krahut, kreshtave, të malit të Rezallës. Mëngjes i hershëm maji. Këngët e zogjve të malit dëgjohen kthjelltë e çiltër para hapave tanë. Cicërojnë të gjithë zogjtë e malit. Qielli i çiltër përflakët me rrezet e gsholit të agimit. Rrezet e diellit vijnë e derdhen vrushkuj mbi majat e lisave të brigjeve të Llaushës, Rezallës... Para syve tanë lëshon shtatin toka e Llaushës. Pastaj, sytë tanë përpjnë tërë katundin. Shtëpitë heshtin kokë me kokë njëra pranë tjetrës. Asnjë oxhak nuk tymon. Asnjë këmbë njeriu nuk duket në udhën e Asfaltit. Heshtje e rëndë. Sikur të merr me vete përpara. Jeta në mes jetës dhe vdekjes... Por, nuk është e shkretë Llausha. Shtëpitë nuk tymojnë. Ato, brenda jetojnë... Pragjet e tyre i ruajnë Llaushasit... Nuk i kanë lënë të shkreta. Jetojnë shtëpitë me burrat e me djemtë e fortë, besnikë të atdheut. Këta janë dora dhe krahu i qëndresës para tmerit e vdekjes që synon t'i

kapërdijë. Diku mes hapave tanë dridhet toka. Mbrëmë e premte, 15 maj 1998 ra një shi i mirë. Me bereqet ra shi i prashëm... Dridhet toka, por nuk luhaten kreshtat. Edhe degët e lisave bunga dhe çarra dridhen. Pehatën njëra mbi tjetrën. Edhe më larg kreshtave dëgjohen granatimet. Rafalët e forcave okupuese e qëllonjë dritën e agimit mbi syprinën e horizontit që lidh kreshtat e Kodrave të Vojvodëve, shpatijet e Gecëve, Kodrën e Gecajve... Bubullimat e armëve të rënda prapohen dhe shtresohen palë - palë në Klysyren e Llaushës, duke bërë jehonë lugut teposhtë të Tushilës, Kopiliqit dhe tutje në Klysyren e Grykën e Açarevës... Topi i armikut vjell zjarr mbi Kodrën e Zejnullahëve. Tutje përplasit ushtimita e gjyleve mbi Kodrën e Rrecit... Nga Kodra e

Zejnullahëve vizatohet si në shuplak të dorës Bjeshka e Rezallës, malet e Deliajve dhe të Zabelajve... Njëpër këto male harkohen e lëshojnë shtatin e udhët e malit, që u bëjnë kurorë lisat e mjegulluara në ditët e maji... Sytë janë të etur ta shohin tokën e Llaushës. Asnjë njeri nuk duket në Llukia të Llaushës... Asnjë traktor nuk gumëzhin... Asnjë lavërtar nuk hapon mbi këto ara që mbiu dheun e tyre... Është koha të hidhet fara e misrit, të prashitën e mihen kopshtijet dhe të mbillen zarzavatet si patatja, domatja, specat e misri. Për sivjet, maji 1998 në arat e Llaushës nuk është mbjellë asnjë kokërr misër... Ecim tokës së Llaushës. Nga degët e lisave tremben shpezët e malit. Fluturojnë duke lëshuar nga një cicërimë... Takojmë



plakun e Vojvodëve, Halimin. Mirë se na keni ardhur, thotë ai, tok më vëlla Rrustemin... Sytë e tyre buzëqeshin gëzim. Për neve, por është drojë. Jemi të rrethuar, thotë plaku. Nuk dihet a na zë të gjallë nata. A i patë lisat e malit kah zbritët, na pyet Rrustemi, 70-vjeçar... Granatat e shkaut i kanë rrjep lisat si t'i kishin gdhendë me teshlicë.

Toka na ka mbetur batallë... edhe qentë në oborr po mundohen të na i vrasë Serbia???! Nuk di pse gjithë këtë hasmëri e ka me neve. Çka i bëmë ne Serbisë? Jemi në tokën tonë dhe shtëpitë tona që po na i rrezon për ditë, nuk kemi çare pa i mbrojtur... Hyqymeti është si vranësira, cohët në bregdet dhe nuk dihet se ku e lëshon shiun...

Jemi bërë një për neve kanë dhembje të gjithë, besa edhe bota e ndjen rrezikun tonë... Sivjet nuk e mbollëm fare tokën. Zine se ka ra breshër. Por toka nuk merret, sepse nuk mund ta ngarkoj në shpinë asnjë hyqymet... Tokat janë mbetur këtu... Ecim dhe përpijmë kulmet e shtëpive. Djemtë dhe burrat e Llaushës qëndrojnë si shkëmbinjtë para pragjeve të tyre. Ata ia kanë dhënë besën tokës, varreve dhe qëndresës... Ecim. Lëvizim duke na shoqëruar dielli mbi tokën e Llaushës. Herë pas here granatimet dridhin degët e lisave... Hëpërhë një re sjell riga shiu. Strehojmë trupin nën degët e shkozave dhe lajthive.



## Një doracak për fushën e edukimit kritik për media

**Bardh FRANGU**

Lindita Aliu Tahiri sjell librin e saj më të ri "Edukimi kritik për media", të cilin e ka botuar shtëpia botuese "Armagedoni" në Prishtinë. Lindita është gjuhëtare, kritike letrare, studiuese e medias, poetë dhe përkthyes letrare. Gjatë vitit akademik 2010/11 ka bërë studime hulumtuese për media dhe edukimin mediatik në Universitetin Maryland në ShBA. Është mësimdhënëse në Universitetin e Prishtinës, ku ligjëron në Departamentin e Gazetarisë, në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze dhe në programin për Përkthim dhe Interpretim në Fakultetin e Filologjisë.

Në parafjalën e saj, me të cilën edhe fillon libri "Edukimi kritik për media", autorja Lindita Aliu Tahiri ka theksuar se punës për bërjen e këtij libri i ka hyrë me motivin dhe dëshirën që t'u shërbejë jo vetëm studentëve të

Departamentit të Gazetarisë, por të gjithë atyre që mendojnë në mënyrë kritike për mesazhet që i marrim nga mediat. Për ta përmbushur të drejtën elementare të njeriut për informim, sipas autores, shumë shoqëri e kanë paraparë lëndën e edukimit për medie në shkollimin formal, madje që në vitet e hershme në kopsht, gjë kjo e cila është menduar edhe nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë si pjesë e kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, brenda fushës "Shoqëria dhe mjedisi", ku përfshihen edhe tema që ndërliken me edukimin për medie.

"Ky libër ka për qëllim që të na nxisë të mendojmë për përgjegjësinë tonë për të ushtruar të drejtën për informim të lirishtëm dhe të saktë, që është parakusht për demokracinë. Si e kemi parë, demokracia dhe zgjedhjet e lira nuk sjellin me automatizëm qeveri të mirë. Nëse qytetarët nuk janë të lirë ta



vlërësojnë informacionin në mënyrë kritike, ata nuk do t'i zgjedhin përfaqësuesit e vet më të mirë", vlerëson me autorja e librit.

Sigurisht se ky libër do të duhej të ishte një doracak i mirë edhe për gazetarët aktivë dhe për ata që duan të merrin me këtë profesion kaq të vështirë që krahaso-

het me profesionin e parashutistit. Prandaj autorja konstaton se për gazetarët e ardhshëm, edukimi kritik për medie është edhe më i rëndësishëm, meqenëse ata do të duhej të jenë të vetëdijshëm për konstruktimin e mesazheve që i ofron publikut, duke e ushtruar këtë detyrë dhe këtë privilegj me transparencë,

etikë dhe vetëdije kritike. Kështu, libri "Edukimi kritik për media" i Lindita Aliut vjen tek ne në kohën kur, siç shprehet Albert Einstein: "Ja kam frikën ditës kur teknologjia do ta kapërcejë komunikimin direkt të njerëzve me njëri-tjetrin; bota do të ketë një brez idiotësh". Pra, ky libër bëhet kaq i nevojshëm meqë vjen në kohën kur, mbështetur në logjikën e konsumit, u jemi nënshtruar informacioneve nga më të ndryshmet, duke humbur sensin për të vërtetën, ndërsa bota vlon nga lajme të rrejshme. Për më tepër, kur dihet fakti se ne jemi një shoqëri e mbyllur, ndikimi negativ i mediave bëhet edhe më i rrezikshëm. Prandaj i vetmi instrument kundër ndikimit negativ të mediave është të menduarit kritik, përkatësisht edukimi kritik dhe estetik mbi to, edhe për faktin se, siç do të thoshte Marquez, jetojmë në një botë ku njerëzit nuk e thonë atë që ndiejnë dhe nuk ndiejnë atë që e thonë.

(Marrë nga zeri.info)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SERBIA - BRAZIL

2

SWITZERLAND - COSTA RICA

1

SOUTH KOREA - GERMANY

2

# Danimarkë - Francë, ndeshja e parë pa gola në 'Rusi 2018'

Danimarka dhe Franca luajtën sot dhe nuk shënuan gola. Ky rezultat i kualifikon francezët të parët e Grupit C dhe Danimarkën të dytën. Peruja është përshëndetur me fitore nga ky Botëror, pasi e ka mposhtur në ndeshjen e fundit Australinë (2-0)

Moskë, 26 qershor - Ndeshja në mes të Danimarkës dhe Francës ka përfunduar 0-0. Ky rezultat i ka kualifikuar më tutje këto dy reprezentacione. Fakt interesant është se pikërisht kjo ndeshje solli edhe barazimin e parë pa gola në këtë Botëror. Francezët do ta kryesojnë grupin, ndërsa danezët kanë kapur vendin e dytë, ashtu siç ishte parashikuar. Ishte një ndeshje pa shumë histori, teksa trajneri Didier Deschamps kishte vendosur ta përdorte rotacionin, ndërsa Danimarka u mundua të bënte diçka, por e kishte shumë të vështirë të depërtonte në zonën e mbrojtur mirë nga francezët. Pjesa e parë nuk solli shumë raste shënimi, kurse në pjesën e dytë francezët krijuan më shumë mundësi shënimi, por pa arritur ta gjejnë golin. Të dyja skuadrat arrijnë objektivin. Peruja ka fituar ndeshjen e nderit ndaj Australisë me rezultatin 2-0. Ishte një fitore e merituar e peruanëve, të cilët kanë shfaqur një futboll tërheqës në këtë Botëror dhe me pak fat dhe përvojë mund të kishin luftuar për një



vend në 1/8-at. Ishte sulmuesi i Watfordit, Carillo ai që zhblokoi rezultatin në minutën e 18 falë një goli madhështor. Pas pushimit, legjenda Guerrero ka shënuar golin e qetësisë për peruanët të cilët e mbrojtën mirë rezultatin deri në fund të takimit. Një Australi zhgënjyese, e cila shënoi dy gola këtë turne, të dyja nga penalltia.

GRUPI C	
Australia - Peru	0-2
Danimarka-Franca	0-0

  

TABELA	
1. Franca	7 pikë
2. Danimarka	5
3. Peruja	3
4. Australia	1

# Sot vendoset fati i Zvicrës, Brazilit dhe Gjermanisë

NIZHNY NOVGOROD, 26 QERSHOR - Fati i Zvicrës së katër shqiptarëve Valon Behramit, Xherdan Shaqirit, Granit Xhakës dhe Blerim Xhemailit vendoset sot (e mërkurë), kur përballen me Kosta Rikën në "Nizhny Novgorod Stadium". Barazimi ndaj Brazilit dhe më pas fitorja e madhe ndaj Serbisë u ka dhënë shanse të mira zviceranëve për të ecur tutje në Kupën e Botës, por në ndeshjen e fundit të grupit i duhet një pikë për të siguruar një gjë të tillë. Ndërsa ndeshja tjetër zhvillohet në mes të Serbisë dhe Brazilit, duke bërë që serbët të jenë afër edhe një humbje tjetër për faktin se Brazili ka ekip cilësor dhe synon vendin e parë në grup. Kampionia aktuale e botës, Gjermania, kërkon kualifikimin në ndeshjen e fundit të grupit. Kundërshtar i tyre do të jetë Koreja e Jugut që ende nuk ka shijuar ndonjë pikë, kurse gjermanët do të kërkojnë një fitore me shumë gola. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi Meksika e ka siguruar kualifikimin dhe Suedia do të kërkojë fitore për t'i provuar shanset e saj pas humbjes në minutat e fundit të kohës shtesë ndaj Gjermanisë.



GRUPI E		GRUPI F	
20:00 Serbia - Brazil		16:00 Meksika - Suedia	
20:00 Zvicra - Kosta Rika		16:00 Koreja e Jugut - Gjermania	

  

TABELA		TABELA	
1. Brazili	4 pikë	1. Meksika	6 pikë
2. Zvicra	4	2. Gjermania	3
3. Serbia	3	3. Suedia	3
4. Kosta Rika	0	4. Koreja e Jugut	0

## SHKURT / KUPA E BOTËS

### "BBC" raporton për fondin për gjobat e "shqiptarëve"

Edhe mediami prestigjioz "BBC" ka raportuar për iniciativën e shqiptarëve që të grumbullohen paratë për t'i paguar gjobat e tre lojtarëve të Zvicrës, të dënuar për festën me shqiptonjë në fitoren ndaj Serbisë në Botëror. Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Stephan Lichtsteiner u gjobitën me 25 mijë franga në total për shkak të festimit në fitoren 2 me 1 ndaj Serbisë. "BBC" ka cekur se nga caku prej 25 mijë eurove janë grumbulluar më shumë se 16 mijë për vetëm 18 orë. Mediami i njohur ka cekur se festimi i lojtarëve simbolizonte flamurin shqiptar dhe se Xhaka e Shaqiri janë shqiptarë nga Kosova, familjet e të cilëve u larguan nga vendlindja për shkak të luftës me Serbinë. Organizatorët kanë thënë se do t'i dhurojnë paratë e grumbulluara për humanizëm, nëse Federata e Zvicrës i refuzon.

### Dele Alli, i gatshëm për ndeshjen ndaj Belgjikës

Në kombëtaren angleze është larguar alarmi për mesfushorin Dele Alli, i cili mungoi në ndeshjen ndaj Panamas (6-1). Futbollisti i Tottenhamit është rikthyer në stërvitje pas shqetësimeve që kishte në kofshë, pas ndeshjes me Tunizinë dhe pritet të luajë në ndeshjen e fundit ndaj Belgjikës.

### Reus: Çdo ndeshje, finale për Gjermaninë

Ylli i Borussia Dortmundit, Marco Reus, ka thënë se tash e tutje të gjitha ndeshjet janë si finale për Gjermaninë. "Ndaj Koresë së Jugut nuk do ta kemi të lehtë, pasi ka lojtarë më të shpejtë sesa suedezët kur sulmojnë, gjithashtu mund të mbështeten te kundërsulmet. Por, çdo ndeshje për ne është si një finale tani", ka thënë Reus.

### Komentatori vdes nga sulmi në zemër pas golit të Arabisë Saudite

Komentatori egjiptian dhe ish-futbollisti i skuadrës Ez-Zemalik, Abdurrahim Muhammed, ka vdekur nga një sulm në zemër pas golit në minutën e fundit të Arabisë Saudite ndaj Egjiptit (2-1). Shefi i Departamentit të Kanaleve Speciale të Televizionit Shtetëror, Usame Behnesi, në një deklaratë për media ka thënë se Muhammedi ishte përgatitur për ta komentuar ndeshjen e grupit A të Kampionatit Botëror Rusi 2018 në mes të Arabisë Saudite dhe Egjiptit në kanalën En-Nil. Behnesi njofton se Muhammedi është emocionuar pas golit të dytë të Arabisë Saudite në minutën e fundit të ndeshjes dhe ka pësuar sulm në zemër.



## Prishtina në Gjibraltar, të enjten përballet me Europa FC

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Skuadra fituese e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina, të martën, me fillim nga ora 15:00, ka fluturuar nga aeroporti i Tiranës drejt

Londrës, më pas nga kryeqyteti anglez drejt Gjibraltarit. Në këtë vend kryeqytetasit e Kosovës janë vendosur në "O'Callaghan Elliott Hotel", kurse të enjten

nga ora 18:00 do të përballet me skuadrën e Europa FC në kuadër të Ligës së Evropës. Po ashtu, janë caktuar edhe gjyqtarët e ndeshjes të cilët janë nga

Portugalia, ndërsa delegati i ndeshjes nga Finlanda. Ende nuk dihet se a do të ketë transferim televiziv të ndeshjes Europa FC- FC Prishtina.



# Drita debuton me fitore në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka debutuar me fitore në Ligën e Kampionëve, pasi e ka mposhtur FC Santa Coloma me rezultat 2-0. Pavarësisht se ishte më e mirë gjatë gjithë ndeshjes, fitues nuk pati në kohën e rregullt dhe skuadrat shkuan në vazhdimë. Lojtari më i mirë i Dritës, Xhevdet Shabani, e shënoi golin e parë në minutën e 99, kurse për rezultatin final 2-0 u përkujdes Fidan Gërbeshi (105) nga penalltia.



Drita do të luajë ndaj fituesit të gjysmëfinalit tjetër të këtij raundi preliminar ndërmjet La Fioritas (San Marino) dhe Lincoln Red Imps (Gjibraltar). Fituesit e dy gjysmëfinaleve do të

përballet më 29 qershor në finale të këtij raundi. Ndërsa fituesi i finales në fazën preliminare do t'i vazhdojë garat në raundin e parë eliminator të Ligës së

Kampionëve dhe do të përballet me skuadrën e Malmos. Tri ekipet e tjera garat do t'i vazhdojnë në Ligën e Evropës, nga raundi i dytë eliminator.

# Hitzfieldi: E gjithë Zvicra qëndron pas Shaqirit, Xhakës dhe Lichsteinerit

CYRIH, 26 QERSHOR - Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka dhe Stephan Lichsteiner janë dënuar më të holla nga FIFA për shkak se me shqiponje i kanë festuar golat në ndeshjen ndaj Serbisë. Ottmar Hitzfield, ish-trajneri i kombëtares zvicerane, ka pohuar se ndihet i lumtur që të tre futbollistët nuk janë dënuar me ndonjë ndeshje moslojë. "Unë kam qenë i bindur që nga fillimi se nuk do të dënohen. Dënimi është tejkualar. Është e natyrshme që të tre janë në bord. Ju bëni gabime në eufori. Në kuptimin njerëzor, është e kuptueshme, por të dy kanë qenë në ato momente në ndikimin e emocioneve. Mesazhet politike nuk lejohen. Në kombëtare tashmë kemi biseduar në vjeshtën e vitit 2014 dhe atyre u kemi thënë se duhet



të përmbahen". "Se nxitimi është një debat është normale. Është një Kupë e Botës, jo vetëm tifozët e futbollit, por i gjithë kombi. Është bërë një gabim, por tani e gjithë Zvicra duhet të qëndrojë prapa kombëtares. Tani, me të gjithë

lojtarët, çdo gjë është e mundur për ekipin", ka deklaruar Hitzfield. Ndryshe, takimin e radhës përfaqësuesja zvicerane do ta zhvillojë kundër kostarikanëve, me fillim në ora 20:00 në "Nizhny Novgorod Stadium".

## SHKURT / "RUSI 2018"

### Pajaziti, trajner i Gjilanit

Skuadra e Gjilanit ka arritur marrëveshje me trajnerin Sadat Pajaziti. Ish-trajneri i KEK-ut dhe Drenicës do ta drejtojë Gjilanin në dy vjetët e ardhshëm. Lajmin e ka bërë me dije skuadra e Gjilanit në faqen zyrtare në "Facebook", kurse me këtë rast ky klub bën me dije se është punuar për t'i sjellë afër ekipit edhe ish-lojtarët e saj, kurse priten edhe transferime nga klubet e Kosovës dhe rajonit si dhe vazhdimi i kontratave me disa prej futbollistëve aktualë.

### Paraqitje mesatare e tenistëve në "Tarragona 2018"

Granit Bajraliu i nisi në mënyrën më të mirë garat e tenisit në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Tenisti Bajraliu shënoi fitore 2:0 në sete (6:1 dhe 6:0) ndaj Mario Zilit të Shqipërisë. Graniti në raundin e dytë takohet nesër me Alexandre Muller nga Franca, njëherësh bartës i dytë i turneut. Ndërsa Blearta Ukëhaxhaj nuk arriti ta mposhtë favoriten nga Tunizia, Chiraz Bechri. Ajo u mposht 2:0 (6:1, 6:1) në sete. Blearta është vetëm 16-vjeçare dhe garimi i saj me seniore është një përvojë e mirë për të. Garuesi tjetër, Burim Bytyqi, nuk arriti ta kalojë sfidën e parë në garat e tenisit. Ai u mposht nga Amine Ahouda i Marokut, 2:0 në sete (6:0 dhe 6:2).

### Beqiri largohet nga Llapi, transferohet te Trepça '89

Portieri Arben Beqiri është larguar nga skuadra e Llapit, kurse menjëherë e ka bërë publik lajmin se do të jetë portier i Trepçës '89 në edicionin 2018/2019. "Falënderoj KF Llapi për bashkëpunimin, kryetarin Nexhat Dumnica, shtabin teknik të trajnerëve në krye me Tahir Batatinën. Duhet veçuar trajnerin e portierëve Labinot Qosa dhe bashkëlojtarët për kohën që e kaluam së bashku. Do të jetë një vit i paharrueshëm në karrierën time. Nga sot jam pjesë e KF Trepça '89 dhe falënderoj kryesinë për besimin që ka në mua për të qenë pjesë e projektit të saj. Më punë dhe me angazhim do t'i arrijmë objektivat e klubit", ka thënë Beqiri.

### Mustafa largohet nga Gjilani

Skuadrën e Gjilanit sot e ka braktisur edhe mesfushori Diar Mustafa. Ka qenë vetë futbollisti ai që ka konfirmuar largimin nga Gjilani. "Nga sot nuk jam më pjesë e SC Gjilanit. Dua t'i falënderoj kryesinë, shtabin teknik, bashkëlojtarët dhe 'Skifterat' për gjithçka. Sukseset!", ka shkruar Mustafa në "Facebook". Nga kjo skuadër janë larguar edhe futbollistët e dëshmuar si Armend Thaqi, Leotrim Bektishi, Betim Haxhimusa dhe Gëzim Rusi.

### Pastore zëvendëson Nainggolanin te Roma

AS Roma menjëherë e ka gjetur zëvendësimin për Radja Nainggolan, i cili është transferuar në Inter. Kryeqytetasit e Italisë e kanë transferuar mesfushorin e PGS-së, Javier Pastore. "Çfarë entuziazmi i jashtëzakonshëm. Jam shumë i lumtur. Forca, Romë!", ishin fjalët e para të Pastores si lojtar i Romës. Pastore edhe në të kaluarën ka luajtur në Serinë A, kur ishte pjesë e Palermos.

## Hardeni, MVP i sezonit në NBA

LOS ANGELES, 26 QERSHOR - James Harden fiton çmimin e lojtarit më të mirë të sezonit në NBA. Ky ishte verdikti kryesor i "NBA Awards" (ceremonia e ndarjes së çmimeve), që u zhvillua në Los Angeles. Basketbollisti i Houston

Rocketsit la pas Russell Westbrookun te Golden State Warriors. Rocketsi e mbylli sezonin e rregullt si skuadra më e mirë, por në play off u thyen pas shtatë ndeshjesh nga Golden State, që në fund triumfoi edhe ndaj Cleveland

Cavaliersit në finalen e madhe. "Mjekroshi" u aktivizua në 72 ndeshje me një mesatare 20.4 pikë për takim, 5.4 rikuperime dhe 8.8 asistime. Hardeni ishte i pari në këtë klasifikim të veçantë, ndërsa finalistët e tjerë ishin Anthony

Davis (New Orleans Pelicans) dhe LeBron James (Cleveland Cavaliers).

Çmimet e sezonit 2017-2018: MVP: James Harden (Houston Rockets), mbrojtësi më i mirë: Rudy Gobert (Utah Jazz), debutue-

si më i mirë: Ben Simmons (Philadelphia 76ers), lojtari i 6 më i mirë: Lou Williams (Los Angeles Clippers), lojtari më improvizues: Victor Oladipo (Indiana Pacers), trajneri i vitit: Dwane Casey (Toronto Raptors).



## REPUBLIC OF KOSOVA

MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT (MED)  
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY & RENEWABLE ENERGY PROJECT (KEEREP)READVERTISING THE REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST FOR  
DEVELOPMENT OF DETAILED DESIGNS, TECHNICAL  
SPECIFICATIONS INCLUDING SUPERVISION,  
COMMISSIONING AND MANAGEMENT SUPERVISION DURING  
DEFECTS LIABILITY PERIOD, FOR ENERGY EFFICIENT  
BUILDING RENOVATIONS, LOT 1

Project no ID P143055

Ref. No. KEEREP/IC5.1/2018/LOT 1

DATE: JUNE 27, 2018

## INTRODUCTION

The Republic of Kosovo has received the financing from the World Bank toward the cost of the Kosovo Energy Efficiency Agency (KEEA) and it intends to apply part of the proceeds to payments for Consulting Services. The consulting services include Development of Detail Designs and Technical Specifications for Energy Efficient Building renovations.

The Ministry of Economic Development (MED), for and on behalf of the Kosovo Energy Efficiency Agency (KEEA), now invites eligible consulting firms ("Consultants") to indicate their interest in providing the services. Interested consultants must provide information indicating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the services.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants [under IBRD Loans and IDA Credits & Grants] by World Bank Borrowers, January 2011 ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms in the form of a joint venture or a sub consultancy to enhance their qualifications.

## DESCRIPTION OF THE ASSIGNMENT

This assignment comes under Component One, Subcomponent C of the Kosovo Energy Efficiency & Renewable Energy Project.

Under the project, the World Bank will provide financing through KEEA for about 149 government buildings. The Consultant will be required to convert completed detailed energy audit reports into tender documents by developing detailed designs, drawings and technical specifications and bills of quantity. The Consultant will also assist in the determination of appropriate package and lot sizes, license requirements, etc.

**FOR Lot 1**, estimated number of buildings for renovation is 17.

The buildings are: 1. Tax Administration, Ferizaj, 2. Pensioner Administration, Ferizaj, 3. Pensioner Administration, Gjilan, 4. Tax Administration, Gjilan, 5. Pensioner Administration, Mitrovica, 6. Faculty of Education, Prizren, 7. Campus Heating, Prizren, 8. Pensioner Administration Prizren, 9. Pensioner Administration, Peja, 10. Faculty of Business, Peja, 11. Archive, Peja, 12. Faculty of Tourism and Management, Peja, 13. Tax Administration, Peja, 14. Faculty of Medicine, Gjakova, 15. Rectorate, Gjakova, 16. Pensioner Administration, Gjakova, 17. Tax Administration, Gjakova. All those buildings are located in Kosovo.

## ACTIVITIES TO BE UNDERTAKEN

The Consultants will be required to provide support in the following activities:

- Prepare detailed technical specifications and basic renovation designs;
- Assisting of MED/Project Implementation Unit on preparation of minimum technical qualifications
- Supervise construction and perform acceptance/commissioning of the construction works
- Management and Supervision during Defects Liability Period (DLP)

Interested Consultants should offer a team composed with the following expertise:

The Consultant should be a consulting firm with relevant project experience. The work should be undertaken by a consulting team consisting of experts who have following skills and credentials:

**Key staff:**

- Team leader / Civil Engineer with at least Master degree in Civil Engineering or related field with 10 year experience relevant to the project.
- Mechanical Engineer with at least 5 years professional experience relevant to the project, preferable in energy efficiency and renewable energy; with at least Master degree.
- Electrical Engineer with at least 5 years professional experience relevant to the project, preferable in energy efficiency and renewable energy; with at least Bachelor degree.
- Architect with at least 3 years professional experience relevant to the project; with at least Bachelor degree.
- Environmental Engineer or equivalent with at least 3 years of experience in hazardous material inventories in buildings, in particular asbestos and experience with requirements and practice for proper asbestos and mercury containing CFLs removal, handling, transport and disposal/storage including monitoring and personal safety equipment requirements.

**NOTE: The above Key staff is required for each lot. If the consultant apply for more than one lot, than need to provide required Key staff for each lot separately.**

**The evaluation and shortlisting criteria are:**

- Firms experience in architecture, engineering, supervision and project designing (40%);
- Relevant work experience in implementing similar projects (40%) and
- Organization and availability of qualified staff with the firm (20%).

A consultant will be selected in accordance with the Consultants Qualification Selection (CQS) set out in the Consultant's Guidelines.

Interested consultants may obtain further information at the address below during office hours 09:00h to 16:00h (Monday to Friday).

Expressions of interest must be delivered to the address below by **July 11, 2018 at 11:00** h Kosovo time.

The Government of the Republic of Kosovo  
Ministry of Economic Development (MED)  
Kosovo Energy Efficiency and Renewable Energy Project (KEEREP)  
Office no.107 (1 floor)  
Mother Theresa Str. no.36  
10 000 Prishtina - Kosovo.

Attn: Mr. Luan Asllani  
Procurement Specialist – MED/PIU  
Ph.: +383 38 200 21 563  
E-mail address: [Luan.Asllani@rks-gov.net](mailto:Luan.Asllani@rks-gov.net)

And  
Attn: Mr. Selami Berisha  
Procurement Director – MED  
Ph.: +383 38 200 21 532

E-mail address: [Selami.Berisha@rks-gov.net](mailto:Selami.Berisha@rks-gov.net)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania „Produkt Invest” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të bllokave të argjilës në Bokshiq, komuna e Klinës.

Njoftohet Publiku i Interesuar se me datën 19. 07. 2018. në ora 13:30 ne hapësirat e restorantit “Hotel Nora” në Zajm komuna e Klinës, do të organizohet debat publik nga Kompania „Produkt Invest” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të bllokave të argjilës në Bokshiq, komuna e Klinës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne impleme

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister

Në mbështetje të nenit 7 pika 1 dhe 5 e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës, të nenit 6, 7 dhe 8 të Rregullores nr.10/2017 për Detyrat, Përgjegjësit dhe Organizimin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Zyra e Kryeministrit shpall:

### KONKURS

Për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kriteret që duhet ti plotësojnë kandidatët për përzgjedhjen e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit janë:

- Letër motivimi me shpjegime të qarta dhe shembuj nga provoja profesionale që tregojnë se si provoja dhe aftësitë përputhen me kërkesat e vendit të punës,
- Diplomë Universitare në fushën relevante,
- Së paku tetë (8) vjet përvojë pune profesionale të cilat së paku pesë(5) vjet përvojë në pozitën udhëheqëse,
- Të ketë aftësi të larta organizative dhe drejtuese,
- Të ketë aftësi të larta të komunikimit dhe negocimit,
- Të jetë njohës i fushës së të drejtës pronësore.

Drejtori dhe Zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryeministri me mandat pesë (5) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje.

#### INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, duhet të dorëzojnë këto dokumente.

CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë

Letër motivimin

Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)

